



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

RAPORT VJETOR

2018





ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Rr. "Ibrahim Rugova", Sky Tower 9/3, Tiranë
Tel: +355 4 2280 371/2
Fax: +355 4 2280 359

Prepared by: **AAB Secretariat**
Design & Layout: **FCB AFIRMA**

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Mesazh nga Kryetari	4
2. Fakte dhe shifra për 2018 - Sektori bankar në Shqipëri	6
3. Struktura Organizative	10
Asambleja e Anëtarëve dhe Bankat Anëtare	10
Komiteti Ekzekutiv	11
Sekretariati	12
Komitete Teknike	12
4. Anëtarët e Shoqatës	13
5. Përmbledhje e veprimtarive të AAB në vitin 2018	14
6. Rregulloret & Mbikëqyrja	15
Çështjet rregullatore të trajtuara gjatë vitit 2018	15
Kuadri rregullator i Bankës së Shqipërisë	15
7. Veprimtaritë e AAB-së	16
Forumet	16
Seminaret	18
Tryeza të rrumbullakëta	22
Marrëveshje bashkëpunimi	23
Aktivitete Sociale	24
8. Edukimi Financiar	29
9. Trajnime	29
10. Publikime	36
11. Komunikimi dhe Marrëdhëniet e AAB-së me Publikun	40
12. Komitetet Teknike të AAB-së (përmbledhje & arritje)	41
13. Takime të tjera gjatë 2018	45
14. Shifra rreth Bankave Anëtare	49
15. Pasqyra Financiare	52

MESAZH NGA KRYETARI

I nderuar Lexues,

Kam shansin të ritakohem sërish me ju në këtë publikim të Raportit Vjetor të AAB-së për vitin 2018. Në këtë publikim, ju do të keni mundësinë të njiheni me shifra dhe fakte për rezultatet e industrisë bankare si pjesë e ekonomisë shqiptare, prandaj kërkoj mirëkuptimin tuaj që pa anashkaluar rëndësinë e tyre, t'ju prezantoj shkurtimisht arritjet kryesore të veprimtarisë së AAB-së për vitin 2018.

Të fokusuar në realizimin e objektivave tona për përmirësimin e ambientit të biznesit, standardeve me të cilat punojmë, përqafimit të digjitalizimit të shërbimeve bankare, bashkëpunimit me aktorë të tjerë në treg, si dhe të edukimit financiar të publikut, do të dëshiroja të veçoja:

1. Pas shumë përpjekjesh, u ra dakord dhe u miratua nga Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave, si pjesë e strategjisë së pagesave, shlyerja e pagesave në euro brenda vendit.
2. Të përfshirë në një debat konstruktiv, dobiprurës dhe në interes të tregut, u arrit që të nxirret një udhëzim i ri për tarifën përmbare, i cili përmirëson udhëzimin mbi tarifën përmbare të miratuar në vitin 2017. Për fat të keq, ky udhëzim nuk ka hyrë ende në fuqi pasi është pezulluar për shkak të apelimit në gjykatë.
3. AAB, nëpërmjet Komitetit të Sigurisë, kërkoj përmirësim të udhëzimit mbi masat shtesë të sigurisë, të cilat u bënë të mundura falë bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
4. AAB organizoi dy forume: një për rritjen e përdorimit të kartës si instrument pagese dhe tjetri për rritjen e përfshirjes financiare nëpërmjet edukimit financiar.
5. Për herë të parë, në kuadër të edukimit financiar, AAB organizoi konkursin mbi paranë (i quajtur Money Quiz), si pjesë e rjetit evropian në një platformë elektronike me nxënës të shkollave 9-vjeçare nga i gjithë vendi. Fituesi mori pjesë në konkursin e Kuizit Evropian të zhvilluar në Bruksel.
6. Së bashku me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankën e Shqipërisë, në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Botërore, u realizua projekti i zhvilluesve të tregut të letrave me vlerë. Projekti ishte pilot deri në fund të vitit 2018 dhe aktualisht është aktiv.
7. Në bashkëpunim të ngushtë me BERZH, AAB zhvilloi idenë mbi mundësinë e krijimit të byrosë së kreditit. Me marrjen e vendimit, shumë diskutime dhe propozime pritët të marrin formë gjatë vitit 2019.
8. Bashkëpunimi me Master Card bëri të mundur zhvillimin e një fushate ndërgjegjësimi për përdorimin e kartave.
9. AAB nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, me Institutin Shqiptar të Auditimit të Brendshëm si dhe për krijimin e Rjetit Shqiptar të Edukimit Financiar (ANFE) (bashkë me 8 organizata të tjera).



Për më tepër ja vlen të theksohet përfshirja e anëtarëve të AAB-së në përgjegjësinë sociale të korporatave dhe në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, të cilave ju është dedikuar një publikim i veçantë.

Duke ju ftuar që të shpenzoni më shumë kohë duke parë më në brendësi të gjitha materialet e tjera, me lejon të theksoj se AAB mbetet përherë një organizatë jo-fitimprurëse e mirë-organizuar, e mirë-drejtuar dhe e mirë-pozicionuar, me synimin për të qenë një model jo vetëm për industrinë bankare, por edhe më gjerë.

Një falënderim i veçantë për të gjithë anëtarët për mbështetjen dhe pjesëmarrjen në të gjitha veprimtaritë dhe nismat tona, për të gjithë bashkëpunëtorët dhe institucionet shtetërore për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e dedikuar, si dhe për stafin e AAB-së.

Lexim të këndshëm!

Me respekt,

Silvio Pedrazzi
Kryetar

SEKTORI BANKAR NË SHQIPËRI

FAKTE DHE SHIFRA



EKONOMIA
U RRIIT ME **4.3%**



KONTRIBUTI I
SHËRBIMEVE FINANCIARE

DHE TË SIGURIMEVE
NGA PBB-SË SHËNOI

2.30%



NORMA E
PAPUNËSISË
U UL

NË **12.3%** NË 2018

NGA **13.7%** NË 2017



DEPOZITAT E
REZIDENTËVE

U VLERËSUAN NË MASËN

68.4%

TË PBB-SË



NIVELI I PUNËSIMIT
NË INDUSTRIJË BANKARE

SI PËRQINDJE E TOTALIT
TË SEKTORIT PRIVAT
JO BUJQËSOR:

1.35%

Sektori bankar, i cili mbulon mbi 90% të aktiveve të sistemit financiar, e përmbylli vitin 2018 me një rezultat financiar pozitiv, në nivele të mira kapitalizimi dhe likuiditet të tepërt, duke shënuar nivele më të larta krahasuar me kërkesat e parashtruara në rregulloren përkatëse, dhe një cilësi më të mirë të kredisë krahasuar me një vit më parë.

(Burimi: Banka e Shqipërisë: Raporti vjetor 2018, faqe 59)



RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

SHËNOI **18.2%**
NGA **17%**
NJË VIT MË PARË



PORTOFOLI I HUAVE PËR BIZNES

SHËNOI
337 992 MILION LEKË



PORTOFOLI I HUAVE HIPOTEKARE

SHËNOI
109 488 MILION LEKË



47.2% E PORTOFOLIT TË HUAS ËSHTË NË LEKË

OSE **2.5%** MË SHUMË
SE GJATË VITIT TË KALUAR



RAPORTI I REFUZIMEVE TË APLIKIMEVE PËR HUA HIPOTEKARE

SHËNOI **10.5%**



RAPORTI I KREDIVE TË KËQIJA

SHËNOI **11.1%**
NGA **13.2%**
NJË VIT MË PARË

Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) përfundoi raundi e pestë të vlerësimit të Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Subjektet financiare u vlerësuan me nivel efikasiteti "të rëndësishme/të konsiderueshme". Në veçanti, bankat treguan se kishin njohuri të mira të rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit dhe të detyrimeve ligjore të lidhura me të.



NUMRI I LLOGARIVE

TË KLIENTËVE NË BANKA SHËNOI

3 115 421



NUMRI I TRANSAKSIONEVE TË BANKINGUT NGA SHTËPIA

2.9 MILION



VLERA E TRANSAKSIONEVE TË BANKINGUT NGA SHTËPIA

886 MILIARD LEKË



LLOGARITË RRJEDHËSE ME AKSES NË INTERNET

400 000

(**12.9 %** TË TOTALIT TË
LLOGARIVE RRJEDHËSE).



NUMRI KARTAVE
PËR PAGESA:
1 128 000



NUMRI I
ATM-VE:
723



NUMRI I
POS-VE:
8 726



NUMRI I PAGESAVE
ME KARTË NË POS: :
3.6 MILION



VLERA E PAGESAVE
ME KARTË NË POS:
21.2 MILIARD LEKË



STRUKTURA ORGANIZATIVE

ASAMBLEJA E ANËTARËVE*

Asambleja e Anëtarëve përbëhet nga përfaqësues të Bankave Anëtare.

Lista e mëposhtme përshkruan në detaje bankat anëtare të AAB-së dhe Asamblenë e anëtarëve:

Alpha Bank Albania / George Papanastasiou, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Amerikane e Investimeve / Andi Ballta, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Kombëtare Tregtare / Seyhan Pencabligil, Drejtor i Përgjithshëm & Anëtar Bordi

Credins Bank / Maltin Korkuti, Drejtor i Përgjithshëm

Credit Bank of Albania / Sherine Kamel, Drejtor i Përgjithshëm

First Investment Bank Albania / Bozhivar Torodov, Drejtor i Përgjithshëm

International Commercial Bank / Gideon Van Der Broek, Drejtor i Përgjithshëm

Intesa Sanpaolo Bank Albania / Silvio Pedrazzi, Drejtor i Përgjithshëm

ProCredit Bank / Adela Leka, Zëdhënëse e Bordit Drejtues

Raiffeisen Bank Albania / Christian Canacaris, Drejtor i Përgjithshëm

Société Générale Albania / Frederic Blanc, Drejtor i Përgjithshëm

Tirana Bank / Dritan Mustafa, Drejtor i Përgjithshëm

Union Bank / Gazmend Kadriu, Drejtor i Përgjithshëm

United Bank of Albania / Muhamed Prlja, Drejtor i Përgjithshëm

* Sipas dhjetorit 2018

ANËTARËT E BORDIT DREJTUES*



Silvio PEDRAZZI,
Kryetar / Drejtor i Përgjithshëm,
Intesa Sanpaolo Bank Albania



Adela LEKA
Zëvendës Kryetare / Zëdhënëse e Bordit
Drejtues, ProCredit Bank Albania



Maltin KORKUTI
Anëtar / Drejtor i Përgjithshëm,
Credins Bank



Dritan MUSTAFA
Anëtar / Drejtor i Përgjithshëm,
Tirana Bank



Andi BALLTA
Anëtar / Drejtor i Përgjithshëm,
American Bank of Investments

Anëtarët e Bordit Drejtues zgjidhen nga Asambleja e Anëtarëve për një mandat dy vjeçar. Anëtarët që e kanë përfunduar mandatin e tyre kanë mundësi të rizgjidhen.

* Sipas dhjetorit 2018

SEKRETARIATI

Veprimtaritë e përditshme të Sekretariatit drejtohen nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Bordi Drejtues. Disa nga detyrat e Sekretariatit, të cilat drejtohen nga Sekretari i Përgjithshëm, janë:

- Të zbatojë vendimet e Asamblesë.
- Të sigurojë që anëtarët të njoftohen për vendimet e Asamblesë së Anëtarëve dhe të Bordit Drejtues dhe për zbatimin e këtyre vendimeve.
- Të përmbushë detyrat që i janë ngarkuar nga Bordi Drejtues.
- Të përfaqësojë AAB në organet qeveritare, në gjykatë dhe me palë të treta (sipas autorizimeve të dhëna), në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Të vendosë në zbatim buxhetin vjetor dhe planin e biznesit.
- Të përgatisë informacione që do të publikohen nga Shoqata dhe t'ia formacione Bordit Drejtues.
- Të mbikëqyrë llogaritë e AAB-së dhe të bashkëpunojë me audituesin.
- Të hartojë dhe të nënshkruajë pasqyrat financiare të AAB-së.



Spiro BRUMBULLI
Sekretari i përgjithshëm
i AAB-së

Z. Spiro Brumbulli aktualisht është Sekretari i përgjithshëm i AAB-së.

KOMITETET TEKNIKE*

- Komiteti i Sigurisë së Bankës – Bajram Ibraj, Intesa Sanpaolo Bank Albania
- Komiteti i Kartave – Nevila Kovaci, Intesa Sanpaolo Bank Albania
- Komiteti i Përputhshmërisë – Ndue Maluta, Banka Kombëtare Tregtare
- Komiteti i Burimeve Njerëzore – Entela Zigori, Intesa Sanpaolo Bank Albania
- Komiteti i Sigurisë së Informacionit – Valsi Thomallari, Alpha Bank Albania
- Komiteti i Auditit të Brendshëm – Silvana Zoto, American Bank of Investments
- Komiteti Ligjor – Veronika Prifti, American Bank of Investments
- Komiteti i Marrëdhënieve me Publikun – Viola Smaja, Raiffeisen Bank
- Komiteti i Sistemeve të Pagesave – Najada Xhaxha, Tirana Bank
- Komiteti i Thesarit dhe Tregut Financiar – Suela Totokoci, Intesa Sanpaolo Bank Albania
- Komiteti i Menaxhimi të Riskut – Brisida Bala, Tirana Bank
- Komiteti i Teknologjisë së Informacionit – Alketa Lamce, Intesa Sanpaolo Bank Albania

* Sipas dhjetorit 2018



ANËTARËSIMET E AAB-SË

AAB-ja është anëtare, anëtare e asociuar ose partnere në organizatat e mëposhtme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Anëtarësimet Ndërkombëtare

- Federata Evropiane e Bankave (EBF)
- Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE)
- Forumi i Shoqatave të Bankave INTERBALKAN

Anëtarësimet Kombëtare

- Këshilli Ekonomik Kombëtar
- Këshilli Tatimor
- Këshilli Ekonomik i Bashkisë së Tiranës
- ICC Albania
- Këshilli Kombëtar i Punës
- Komiteti i Sistemit Kombëtar të Pagesave

PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARIVE TË AAB-SË NË VITIN 2018

- Asambleja e Anëtarëve zhvilloi 4 mbledhje të rregullta dhe Bordi Drejtues zhvilloi 6 mbledhje.
- Miratimi i projektit të klerimit të pagesave në euro brenda vendit.
- Udhëzimi për Tarifat e Përmbaresve Privat.
- Udhëzimet për masat shtesë të sigurisë.
- AAB organizoi forumin e kartave me temë: "Transformimi i kartave dhe pagesave drejt një ekonomie jo cash".
- AAB organizoi Forumin për Edukimin Financiar me temë: "Fuqizimi i Edukimit Financiar përmes Përfshirjes Financiare".
- AAB ishte bashkë-organizatore për zhvillimin me sukses të aktiviteteve gjatë Javës Evropiane të Parasë. Si pjesë e Javës Evropiane të Parasë u organizua gjithashtu edhe Kuizi Evropian i Parasë.
- Projekti pilot "Zhvilluesit e Tregut".
- U nënshkruan tre Marrëveshje Bashkëpunimi.

RREGULLORET DHE MBIKËQYRJA

Çështjet rregullatore të trajtuara gjatë vitit 2018

Gjatë vitit për përgjatë dekadës së fundit, bankat janë përballur me ndryshime të shumta rregullatore. Tre çështje kryesore rregullatore ishin në vëmendje të industrisë bankare:

Udhëzimi për Tarifat e Përmbaresve Privat - pas nxjerrjes së udhëzimit të përbashkët nga Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave nr. 385/7, datë 28.6.2017 "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat", gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018, AAB, përmes organeve të saj drejtuese, vazhdoi të kundërshtonte fuqishëm udhëzimin në fjalë, veçanërisht kundër tarifave të larta të vendosura për këto shërbime. Së fundi, më 30.08.2018 Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë nënshkruan udhëzimin e përbashkët Nr. 30 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përbashkët Nr. 385/7, datë 28.6.2017 "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat", përmes së cilit u vendos një rregullim i arsyeshëm i këtyre tarifave.

Paketa Fiskale – gjatë vitit 2018, Sekretariati i AAB-së dhe Komitetet Teknikë të saj patën diskutime të gjëra lidhur me nevojat për ndryshime në paketën fiskale, me synimin për të pasur akte rregullatore më të mira dhe më të detajuara, duke i harmonizuar me praktikën më të mira të BE-së dhe vendeve të rajonit. Propozimet e AAB-së kryesisht u përqendruan në nevojën për ndryshime në ligjet «Për procedurat tatimore», «Për tatimin mbi vlerën e shtuar», si dhe çështjen e zbatimit të standardeve të IFRS 9 (propozimet specifike të AAB-së të përgatitura në bashkëpunim me KPMG duhet të përfshihen në legjislacionin tatimor).

Masa shtesë të sigurisë - në 2018, AAB vazhdoi të sjellë në vëmendje problematikat e Udhëzimit të nxjerrë nga Ministri i Brendshëm «Për caktimin e nivelit dhe llojit të masave shtesë të sigurisë». Pas shqetësimit të ngritur nga AAB, në 6 nëntor 2018, Ministri i Brendshëm nxori një udhëzim të ri, i cili shfuqizoi udhëzimin e kundërshtuar nga AAB, duke marrë kështu në konsideratë disa nga shqetësimet e ngritura nga AAB.

Kuadri rregullator i Bankës së Shqipërisë

Gjatë 2018, AAB ka qenë e angazhuar tërësisht në dhënien e komenteve dhe sugjerimeve për draft rregulloret e Bankës së Shqipërisë, të cilat më pas u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i BSH-së, si vijon:

- Ndryshimet në rregulloren «Për menaxhimin e riskut të likuiditetit» - këto ndryshime konsistojnë në rritjen e nivelit minimal të kërkuar për aktivet likuide kundrejt pasiveve me tregues afatshkurtër në monedhë të huaj dhe në ruajtjen e nivelit minimal të këtij treguesi për monedhën vendase të pandryshuar.
- Ndryshimet në rregulloren «Për transparencën për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare» - këto ndryshime trajtuan disa nga problemet me të cilat përballet sektori bankar në lidhje me transparencën e klientëve, si dhe përafrimin e mëtejshëm me Direktivat Evropiane për Mbrojtjen e Konsumatorit.
- Ndryshimet në rregulloren «Për kreditë konsumatore dhe hipotekare» - ndryshimet në këtë rregullore u përcaktuan në kuadër të masave të ndërmarra për kontrollin dhe zvogëlimin e nivelit të pagesave në euro në sistemin financiar, si dhe përafrimin me kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian 2014/17/BE.
- Rregullorja «Për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme» - Kjo rregullore parashikon përcaktimin e përmbajtjes së planit të ndërhyrjeve të jashtëzakonshme, në zbatim të ligjit «Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë», duke specifikuar procesin e vlerësimit të mundësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, si dhe identifikimin e kategorive kryesore të informacionit të nevojshëm për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Gjatë vitit 2018, AAB u përfshi gjerësisht, përmes Komiteteve të saj Teknikë, në: projektligjin e ri «Për shërbimet e pagesave» të paraqitur nga Banka e Shqipërisë, draft rregulloren e Bankës së Shqipërisë «Për disa ndryshime në rregulloren «Për kapitalin rregullator të bankës».

VEPRIMTARITË E AAB-SË

2 Forume

11 Seminare

2 Tryeza të rrumbullakëta

3 Marrëveshje Bashkëpunimi të nënshkruara

FORUMET

AAB - Forumi i Kartave

4 maj 2018 - Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) organizoi Forumin e Kartave me tematikë: «Transformimi i kartave dhe pagesave drejt një ekonomie jo cash». Ky forum u organizua me mbështetjen e PayLink dhe Asseco. Në këtë forum morën pjesë përfaqësues të ndryshëm nga institucione publike, banka qendrore, bankat tregtare, institucione financiare kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqëri private, organizata të biznesit, Shoqata Helenike e Bankave dhe Shoqata e Bankave të Kosovës.

Për herë të parë, AAB organizoi këtë forum në një format të ri, të ndarë në dy sesione, ku secili prej tyre ishte i konceptuar si një panel diskutimi për trajtimin e çështjeve të ndryshme që lidhen drejt-përdrejtë me këtë temë. Në përfundim të këtij forumi, aktorët e këtij tregu u ftuan të marrin pjesë në një fushatë edukimi që synon rritjen e përdorimit të kartave si një instrument pagese. Të gjitha çështjet e identifikuara gjatë këtij Forumi u ndoqën me vëmendje nga AAB përgjatë muajve të vijim.

Në këtë kuadër, AAB prodhoi një video për të promovuar përdorimin e instrumenteve të pagesave, duke sjellë kështu reduktimin e pagesave cash.





Forumi i Edukimit Financiar

29 qershor 2018 - U zhvillua Forumi i titulluar "Fuqizimi i përfshirjes financiare përmes Edukimit Financiar". Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe me mbështetjen e Bursës Shqiptare të Titujve (ALSE), Shoqatës Shqiptare të Tregtimit të Titujve (ASTA) dhe Shoqatës Shqiptare të Mikro-Financave (AMA). Mes pjesëmarrësve të tjerë, në këtë forum morën pjesë përfaqësues të shumtë nga Banka e Shqipërisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucione të tjera publike, shoqata të ndryshme, organizata jofitimprurëse, rrjete akademike në vend, përfaqësues të sektorit bankar dhe financave, përfaqësues të mediave, etj.

Gjatë punimeve të këtij forumi u mbajt edhe ceremonia e nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit mes Shoqatës Shqiptare të Bankave, Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë, Shoqatës Shqiptare të Mikro-Financave, Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve, Shoqatës Shqiptare të Tregtimit të Titujve, Bursës Shqiptare të Titujve (ALSE), Junior Achievement Albania, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe Shërbimit Kombëtar të Rinisë. Ky Memorandum Mirëkuptimi synoi themelimin e Rrjetit Shqiptar të Edukimit Financiar (ANFE) dhe rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional për edukimin financiar.

SEMINARE

Më 1 mars, AAB në bashkëpunim me Mellon Group, organizuan një seminar të përqendruar në transformimin digjital dhe Direktivën e Shërbimeve të Pagesave Sekondare (PSD2). Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, AAB, bankat anëtare dhe bankat në Kosovë. Objektivi i këtij seminari ishte të ofronte këshilla për pjesëmarrësit në kontekstin e ndryshimit të tendencës së tregut, mjedisit teknologjik dhe rregullator.



Konvertimi i OZHQ-ve në Biznes

Më 24 maj, AAB në bashkëpunim me ICC Albania dhe OKB në Shqipëri, organizuan një seminar për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), të cilat synojnë të ndihmojnë pjesëmarrësit të kategorizojnë objektivat e tyre në varësi të reflektimit të tyre përkatës. Në këtë seminar morën pjesë përfaqësues të AAB dhe ICC Albania.



Takimi vjetor i Grupit të Përdoruesve SWIFT (UGM)

Më 7 qershor, u organizua takimi vjetor i UGM-së. Ky takim u zhvillua në dy pjesë dhe u ndoq nga përfaqësues të bankave anëtare si p.sh.: CISO – Drejtuesit e Sigurisë së Informacionit, Drejtorët/menaxherët e IT; personat kyç të kontaktit për SWIFT dhe përfaqësues të Bankës së Shqipërisë. Ky takim u përqendrua në zhvillimet e platformës SWIFT dhe përditësimin e programeve të sigurisë dhe pajtueshmërisë së klientëve.



Transformimi digjital në sektorin bankar

Më 26 qershor u organizua një mëngjes biznesi me përfaqësues të bankave anëtare me temën «Transformimi Digjital në Banka». Fokusi i këtij takimi ishte rruga e Transformimit Digjital për bankat tradicionale, "Vlera e Vërtetë e platformës me kanale Omni" dhe "Automatizimi i Procesit". Takimi u organizua në kuadër të strategjisë së AAB-së për promovimin e transformimit digjital dhe sfidat e digjitalizimit. Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Symmetric Group, partner i New Frontier Group.



Seminari për PSD 2

Më 26 shtator, AAB në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE) organizuan një seminar për PSD 2 (Direktivën e Shërbimeve të Pagesave). Ky aktivitet u mundësua nga Online Business Technologies. Në këtë seminar u mbuluan çështje të tilla si të rehat më të fundit mbi nismat API në Evropë dhe standardet API si zgjidhja më e mirë për bankat.



Seminar për zhvillimin e karrierës

Më 12 tetor, AAB organizoi një seminar për «Zhvillimin e Karrierës» nën drejtimin e ekspertit ndërkombëtar të trajnuesve në fushën e zhvillimit të karrierës, si dhe për rritjen e aftësive personale dhe aftësive të menaxhimit. Në këtë seminar u diskutuan gjerësisht tema interaktive si p.sh.: influencat për zgjedhjet në karrierë, llojet e karrierës, aftësitë kryesore të nevojshme për karrierën në të ardhmen dhe një grup idesh të tjera në lidhje me zhvillimin e karrierës.



Për Sigurinë Kibernetike

Ky seminar, i organizuar në kuadër të Muajit të Ndërgjegjësimit për Sigurinë Kibernetike, u zhvillua në 18 tetor. Një aktivitet i suksesshëm i organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave për tu mbledhur së bashku dhe për të krijuar kontakte për çështjet e sigurisë kibernetike dhe të informacionit. Objektivi i këtij seminari u arrit duke mbledhur së bashku ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të sigurisë kibernetike, përmes shkëmbimit të njohurive dhe prezantimit të qasjeve të zhvillimit, praktikave të mira dhe mundësive të ndryshme rreth kësaj teme.



Krijimi i Byrosë Kombëtare të Kredive në Shqipëri

Më 19 tetor, në ambientet e AAB-së u organizua një seminar lidhur me projektin e Byrosë Kombëtare të Kredive, me praninë e ekspertit ndërkombëtar Jim Aziz nga Baja Group Consultants. Në këtë seminar u shpalsën njohuri të shumta për zhvillimin e Byrosë Kombëtare të Kredive në Shqipëri, duke u përqendruar në tema të rëndësishme, si p.sh.: krijimi i një Byroje të kredive private për Shqipërinë dhe potenciali i kësaj Byroje në Shqipëri. Gjatë këtij seminari, eksperti shpjegoi disa shqetësime të ngritura nga pjesëmarrësit.



Rregullorja për mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin bankar

Më 7 nëntor, AAB, në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP), organizuan një seminar lidhur me rregulloren e mbrojtjes së të dhënave personale dhe ndikimin e saj në sistemin bankar. Në funksion të kërkesave të përputhshmërisë sipas Rregullores së Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), ky seminar pati si objektiv vendosjen e një emëruesi të përbashkët për dispozitat e ndryshme të kësaj rregulloreje dhe atë që bankat duhet të bëjnë për të vepruar në përputhje me këtë rregullore. Në këtë seminar morën pjesë përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ekspertë të sektorit bankar.



Kërkesat rregullatore në lidhje me rolin e auditimit të brendshëm në banka

Më 16 nëntor, AAB organizoi një seminar me temë «Kërkesat rregullatore lidhur me rolin e auditimit të brendshëm në banka», e konsideruar si një nga prioritetet e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të AAB.. Gjatë këtij aktiviteti, u diskutuan kërkesat rregullatore që prekin funksionin e audituesit të brendshëm dhe gjithashtu pritshmëritë në lidhje me këtë çështje.



Drejt digjitalizimit: Si të kthehemi në një bankë kryesisht digjitale

Më 21 nëntor, AAB-ja, në partneritet me KOBIL Systems, organizoi një seminar për transformimin digjital. Përveç përfaqësuesve të bankave anëtare të AAB-së, në këtë seminar morën pjesë edhe përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe ekspertë të sistemit financiar dhe sistemeve të pagesave.



TRYEZA TË RRUMBULLAKËTA

Tryezë e rrumbullakët për sektorin bankar italian dhe atë shqiptar

Më 20 shkurt, AAB-ja organizoi një tryezë të rrumbullakët me fokus në sektorin bankar italian dhe atë shqiptar. Kjo tryezë mbledhi së bashku përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë, drejtorët e përgjithshëm dhe menaxherët e nivelit të lartë nga disa banka, Ambasadorin Italian në Tiranë, si dhe përfaqësuesit e Shoqatës Shqiptare dhe Italiane të Bankave (ABI), për të diskutuar mbi situatën aktuale, perspektivat dhe sfidat e industrisë bankare.

Ky aktivitet u mirëprit nga Kryetari i AAB-së, Z. Silvio Pedrazzi, i cili prezantoi një përmbledhje të sistemit bankar në Shqipëri, me fokus të veçantë në strukturën e sistemit bankar shqiptar dhe tendencat e fundit ekonomike dhe financiare.

Parë në një këndvështrim rregullator, Z. Deniz Deralla, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë, prezantoi zhvillimet më të fundit të kuadrit rregullator dhe masat përkatëse të ndërmarra për ndërmjetësit e huaj. Palët ranë dakord të vazhdojnë përpjekjet bashkëpunuese tashmë të nisura më parë dhe të forcojnë partneritetin dhe bashkëpunimin për çështje me interes të përbashkët.

Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave

Më 29 maj, AAB-ja organizoi një tryezë të rrumbullakët lidhur me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR). Ekspertët e Raiffeisen Bank prezantuan ndryshimet e fundit dhe kërkesat kryesore të kësaj rregulloreje, si dhe ndanë me të pranishmit përvojën e tyre në lidhje me zbatimin e këtyre kërkesave. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga departamentet e përputhshmërisë, ligjore dhe teknologjisë së informacionit të bankave anëtare, të cilët ishin pjesë aktive e diskutimeve.



MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT

Bashkëpunimi i AAB-së me institucionet dhe organizatat e tjera vazhdoi të rritet me hapa të shpejtë. Objektivi i këtyre marrëveshjeve është të sigurojnë që, përmes bashkëpunimit me organizata të tjera për çështje me interes të përbashkët, të krijohen sinergji, duke rritur kështu efikasitetin në projekte dhe fushata të përbashkëta.

Marrëveshjet e nënshkuara nga AAB-ja me palë të tjera gjatë vitit 2018 janë si më poshtë:

- Memorandum Bashkëpunimi mes Shoqatës Shqiptare të Bankave, Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë, Shoqatës Shqiptare të Mikro-Financave, Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve, Shoqatës Shqiptare të Tregtimit të Titujve, Bursës Shqiptare të Titujve (ALSE), Junior Achievement Albania, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe Shërbimit Kom-bëtar të Rinisë. Ky Memorandum Mirëkuptimi synoi themelimin e Rrjetit Shqiptar të Edukimit Financiar (ANFE) dhe rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional për edukimin financiar.
- Marrëveshja e bashkëpunimit midis Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD) e nënshkruar në 17 dhjetor. Kjo marrëveshje synon shkëmbimin e përvojave profesionale në fushat me interes të përbashkët, shkëmbimin e rregullt të informacionit, krijimin e grupeve të përbashkëta të punës për trajtimin e çështjeve të ndryshme, etj. Në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta, palët do të organizojnë seminare dhe konferenca të një natyre shkencore dhe praktike, leksione të hapura me nxënës dhe studentë, si dhe fushata edukimi financiar për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave në vend.
- Marrëveshja e Bashkëpunimit me Institutin Shqiptar të Auditimit të Brendshëm (AIIA) si rezultat i një procesi bashkëpunimi midis dy palëve, nënshkruar në 21 dhjetor. Kjo marrëveshje përcakton fushat e bashkëpunimit midis palëve, d.m.th .: koordinimin e nismave të përbashkëta dhe krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e sektorit bankar si dhe trajnime të përbashkëta që synojnë rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në sektorin bankar dhe financiar.



AKTIVITETE SOCIALE

Ceremoni Përcjellje dhe Mirëseardhje

AAB organizoi ceremoni përcjellje për nder të disa ish - Drejtorëve të Përgjithshëm të bankave dhe u uroi mirëseardhjen drejtorëve të rinj.

- Ceremonisë e përcjelljes dhe mirëseardhjes e organizuar në 8 shkurt shërbeu si një “mirupafshim” për Z. Periklis Drougkas, i cili la postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Alpha Bank Albania dhe Kryetarit të AAB-së, dhe për Z. Pierlouigi Caferrri i cili la postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Veneto Banka. Gjithashtu, kjo pritje shërbeu si një urim mirëseardhje për Z. Georgios Papanastasiou, Drejtori i ri i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania.
- Më 3 korrik, AAB-ja organizoi një ceremoni përcjellje për nder të Z. Ioannis Agathos, me rastin e përfundimit të misionit të tij si Drejtor i Përgjithshëm i NBG Bank Albania. Në këtë organizim morën pjesë Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të AAB-së, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.
- Gjatë Mbrëmjes së Fundvitit, më 12 dhjetor, AAB-ja përcolli Z. Frederic Blanc, i cili përfundoi mandatin e tij në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të bankës Société Générale Albania për të ndjekur karrierën e tij në Francë brenda Société Générale Group. Në emër të AAB-së, Z. Silvio Pedrazzi falënderoi Z. Blanc për bashkëpunimin dhe kontributin kushtuar Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe për drejtimin e një banke me emër të mirë në Shqipëri. Gjithashtu, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Z. Gent Sejko shprehu falënderimet e tij të posaçme për Z. Blanc.



Udhëtim trajnimi me gazetarët ekonomikë

Për të katërtin vit radhazi, AAB-ja organizoi udhëtimin e përvitshëm për shtyp për gazetarët e ekonomisë. Aktiviteti u organizua në 2-4 nëntor në qytetin e Janinës, Greqi me mbështetjen e Bankës Amerikane të Investimeve (ABI) dhe Union Bank. Edhe këtë vit, ky aktivitet u ideua si një kombinim i trajnimit dhe një udhëtimi argëtues. Organizimi i udhëtimeve të tilla mbështetet në bashkëpunimin e ngushtë të krijuar midis AAB-së, bankave anëtare dhe përfaqësuesve të mediave.



Mbrëmja e Fundvitit

Më 12 dhjetor, AAB-ja organizoi Mbrëmjen e Fundvitit, ku morën pjesë Drejtorë të Përgjithshëm të bankave tregtare dhe Kryetarët e Komiteteve Teknike të AAB-së. Në këtë aktivitet të fundvitit, përveç Guvernatorit Z. Gent Sejko dhe përfaqësuesve të tjerë të Bankës së Shqipërisë, morën pjesë edhe Zëvendëskryeminstrija, Zj. Senida Mesi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Z. Besnik Dervishi, dhe Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Z. Genci Mamani.



EDUKIMI FINANCIAR



Edukimi financiar është thelbësor në mënyrë që të gjithë të mund të menaxhojnë më mirë të ardhurat dhe shpenzimet e tyre personale dhe të përfitojnë njohuri më të gjera për ekonominë dhe financat. Për shumë vite radhazi, bankat, individualisht dhe përmes AAB-së, kanë qenë jashtëzakonisht aktive në këtë fushë.

Forum i hapur për sistemin bankar shqiptar

Më 8 janar, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, Dr. Spiro Brumbulli, ishte i ftuar në një leksion të hapur në Universitetin Epoka. Ky aktivitet u organizua nga YEN Club (Rrjeti i Ekonomistëve të Rinj) dhe Z. Brumbulli mbajti një prezantim interaktiv mbi sektorin bankar, arritjet dhe sfidat dhe kontributin e këtij sektori në ekonomi.



Konferenca Studentore për Ekonominë, Financat, Biznesin dhe Shkencat Sociale

Më 25 qershor, Departamenti i Ekonomisë në Universitetin Epoka në bashkëpunim me Shoqatën Ekonomike të Shqipërisë (ESA), Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Rrjetin e Ekonomistëve të Rinj organizuan Konferencën Studentore për Ekonominë, Financat, Biznesin dhe Shkencat Sociale, SCE-2018. Gjatë kësaj konference u diskutuan katër tema kryesore: Popullsia, Emigracioni dhe Siguria; Tregtia Ndërkombëtare; Rritja dhe zhvillimi ekonomik; Normat e këmbimit valutor dhe inflacioni. Dr. Spiro Brumbulli, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, si folës kryesor, prezantoi disa sugjerime dhe informacione mbi sfidat e shoqërisë në Shqipëri dhe përtej saj.

Leksione të hapura për Auditimin e Brendshëm

Përgjatë muajit maj, AAB-ja organizoi disa leksione të hapura me pjesëmarrjen e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

- Në 17 maj, në bashkëpunim me Fakultetin e Biznesit "Aleksandër Moisiu" (UAMD), u zhvillua një leksion i hapur me temë "Të njohim Auditimin e Brendshëm - një profesion që bën ndryshimin". Ky leksion u drejtua nga Zj. Silvana Zoto, Drejtore e Auditimit të Brendshëm në NBG Bank Albania dhe Kryetare e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në AAB, dhe Zj. Daniela Hoxha, Drejtore e Departamentit të Auditimit të Brendshëm në Bankën Kombëtare Tregtare.

- Më 29 maj, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Evropian të Tiranës (UET) u mbajt një leksion i hapur me të njëjtën temë, me pjesëmarrjen e Zj. Silvana Zoto. Gjatë këtij leksioni të hapur, ajo u shoqërua nga Drejtori Ekzekutiv i Bursës Shqiptare të Titujve (ALSE), Z. Artan Gjergji, i cili prezantoi temën "Bursa e Shqipërisë si një mundësi investimi".

Më 31 maj, në bashkëpunim me Universitetin "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan u organizua leksioni i hapur lidhur me rolin dhe funksionet e auditimit të brendshëm në institucionet financiare. Ky leksion u drejtua nga Zj. Ediola Biçaku dhe Zj. Glejda Hibraj, Drejtuese të Departamenteve të Auditimit të Brendshëm, përkatësisht në Intesa Sanpaolo Bank Albania dhe Fibank Albania.



Java e Parasë në Shqipëri, 12-18 mars

Më 12-18 mars 2018, në Shqipëri u lançua Java e Parasë, nën moton "Paraja: Ç'të mbjellësh, do të korrësh!». Aktivitetet u organizuan në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë (BSH) dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave (DIA), Junior Achievement (JA), Shërbimit Kombëtar të Rinisë (NES), shkollave, universiteteve publike dhe jopublike, etj. me pjesëmarrjen e:

5000 fëmijë dhe të rinj
55 shkolla nëntë-vjeçare
14 shkolla të mesme
8 universitete
14 qytete



JAVA E PARASË

Ceremonia e Lançimit të Javës së Parasë u zhvillua në Muzeun e Bankës së Shqipërisë (BSH). Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe Kryetari i AAB-së mbajtën fjalën e tyre përshëndetëse, gjatë së cilës ata theksuan rëndësinë e edukimit financiar në Shqipëri, veçanërisht për brezin e ri. Ceremonia vijoi me ndarjen e çmimeve për fituesit e tre konkurseve, të cilat BSH dhe AAB prezantuan në mbështetje të Javës së Parave.

- Konkursi i parë, me temën e Javës së Parasë 2018 «Paraja: Ç'të mbjellësh, do të korrësh!», synoi të përfshinte nxënësit e klasës së gjashtë të cilët prezantuan projekte kreative, si për shembull vizatime dhe instalacione të ndryshme. Ky konkurs u mbështet nga Raiffeisen Bank Albania. Objektivi i këtij konkursi ishte të krijonte projekte, si p.sh. vizatime dhe instalacione të ndryshme, të cilat përcjellin qartë konceptin e tyre të menaxhimit të parasë. Në total, 144 nxënës nga 21 shkolla fillore prezantuan 70 projekte.

- Në konkursin e dytë, një konkurs me video, u ftuan nxënësit e shkollave të mesme të paraqesin mesazhet e tyre lidhur me temën «Paraja: Ç'të mbjellësh, do të korrësh!», qoftë në skuadër apo edhe individualisht. Në total, u shpallën tre fitues nga 24 kandidatë që morën pjesë në këtë konkurs, nga 40 studentë në të gjithë Shqipërinë. Ky konkurs u zhvillua me mbështetjen e Bankës Amerikane të Investimeve.
- Konkursi i fundit ishte një sfidë për studentët e universitetit për hartimin e eseve argumentuese me temë: «A përbën rrezik përdorimi i euros në transaksione tregtare në Shqipëri?», mbështetur nga Banka Societé Generale Albania.

Gjithashtu, gjatë gjithë javës, shumë të rinj vizituan Muzeun e Bankës së Shqipërisë dhe banka të tjera tregtare. Studentët gjithashtu patën mundësinë të ndjekin leksionet e organizuara në BSH dhe në universitete të ndryshme. Për më tepër, aktivitetet e Javës së Parasë u diskutuan në shumë emisione televizive, ku përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave dhe ekspertë të tjerë të çështjeve të edukimit financiar folën për gjerësisht për Javën e Parasë.

Kuizi Evropian i Parasë në Shqipëri: Promovimi i Edukimit Financiar

Më 12 prill, Shoqata Shqiptare e Bankave në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, organizuan Kuizin Evropian të Parasë, ku afërsisht 500 studentë të shkollave të mesme në të gjithë Shqipërinë garuan përballë njëri-tjetrit në një konkurs kombëtar të transmetuar drejtpërdrejtë përmes Kahoot!, një platformë e të mësuarit online. Fëmijë nga mosha 13 deri në 15 vjeç nga 35 shkolla të ndryshme morën pjesë në këtë kuiz. Pyetjet u drejtuan në një transmetim të drejtpërdrejtë dhe përgjigjet u dërguan në kohë reale përmes aplikacionit Kahoot!. Ekipi fitues ishte nga shkolla e mesme "Sotir Gurra" në Korçë. Gjithashtu, edhe Banka e Shqipërisë i shpërbleu fituesit me dhurata simbolike.

Në maj të vitit 2018, të gjithë fituesit e konkurseve kombëtare të edukimit financiar në vendin e tyre udhëtuan drejt Brukselit, me ftesë të shoqatës së tyre kombëtare të bankave. Kuizi Evropian i Parasë u organizua për herë të parë këtë vit, dhe 50 studentë nga 25 vende të ndryshme garuan në finalen e zhvilluar në Bruksel. Ekipet nga Polonia, Irlanda dhe Gjermania ishin kampionët e parë në Evropë të Kuizit të Parasë.



TRAJNIME

Investimi në kualifikimin dhe ritjen e aftësive të punonjësve është një nga prioritetet kryesore për AAB-në. Gjatë viteve të fundit, ne kemi zhvilluar **25** trajnime brenda shoqatës sonë me pjesëmarrjen e **392** punonjësve të bankave, në bashkëpunim me **11** partnerët tanë të trajnimit.

Për herë të parë, janë ofruar dy trajnime online për 215 punonjës.

TRAJNIME NË 2018

Tema: Trajnim për SNFR dhe Taksat

Data: 14-16 shkurt

Partner: KPMG Albania

Pjesëmarrës: 16

Përshkrimi: Ky program mbuloi raportimet e përgjithshme dhe kërkesat tatimore, të cilat konsiderohen si më të rëndësishme për subjektet tregtare si klientë të bankave dhe për objektivat e oficerëve të kredisë në banka, me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre të leximit dhe interpretimit të informacionit financiar të vendosur në dispozicion nga subjekte të ndryshme në Shqipëri.

Tema: Auditimi i IT-së për audituesit jo IT

Data: 22-23 shkurt

Partnerë: Instituti Shqiptar i Auditimit të Brendshëm (AIIA)

Pjesëmarrës: 18

Përshkrimi: Një panel ndërveprues i ndarjes së përvojave të pjesëmarrësve si nga funksionet e fushës së biznesit ashtu edhe nga auditimi i teknologjisë së informacionit. Përveç teorisë, pjesëmarrësit dhanë kontribut vetë duke marrë pjesë në bashkëveprim dhe duke punuar së bashku në një studim rasti ku përmbledhen të gjitha llojet e çështjeve të lidhura me auditimin e IT.

Tema: Prova e vlerës së Trajnimit - ROI

Data: 15-16 mars

Partnerë: AIMS International

Pjesëmarrës: 13

Përshkrimi: Ky program prezantoi një përditësim të praktikave të vlerësimit të brendshëm, si dhe u zbatua një vlerësim i planifikuar Kthimit nga Investimi (ROI) Ky trajnim u mundësoi pjesëmarrësve të provojnë vlerën e programeve të trajnimit, të komunikojnë rezultatet me palët e interesuara, të përmbledhin/mësojnë të tjerët metodologjinë e ROI, të zgjerojnë dhe zbatojnë programe të suksesshme dhe të riprojektojnë/ndërpresin programet joefektive.

Tema: Mashtrimi: Mbrojtje e Avancuar duke njohur dhe zbuluar mashtruesit

Data: 21-22 Mars

Partnerë: Instituti Shqiptar i Auditimit të Brendshëm (AIIA)

Pjesëmarrës: 22

Përshkrimi: Ky kurs i prezantoi pjesëmarrësit me përfitimet e miratimit të një sistemi i cili ndihmon në parandalimin, zbulimin, kuantifikimin dhe përgjigjen ndaj kërcënimeve të mashtrimit. Të pranishmit zbuluan aftësi dhe teknika të cilat do të dëshmojnë se janë të vlefshme në zbutjen e rrezikut nga burimet e jashtme.



Tema: Vlerësimi i Kredive dhe Analiza e Fluksit Monetar

Data: 17-19 prill

Partnerë: House of Training – ATTF

Pjesëmarrës: 23

Përshkrimi: Ky trajnim, i drejtuar nga eksperti Eric de Jong, kishte për qëllim të ndihmonte ofruesit e ardhshëm dhe aktualë të kredive, investitorët dhe analistët e kredisë për të kryer punën e tyre në mënyrë efektive dhe të plotë. Në trajnim morën pjesë 23 persona nga banka dhe institucione financiare jo-bankare.

Tema: Menaxhimi efektiv i riskut - Mjete dhe Praktika

Data: 19-20 prill

Partnerë: IFC

Pjesëmarrës: 17

Përshkrimi: Një trajnim dy-ditor interaktiv për të rishikuar praktikën e menaxhimit të riskut dhe pajisjen e profesionistëve vendas me mjetet e nevojshme për të zbatuar praktikën më të mirë në institucionet e tyre. 17 pjesëmarrës nga 9 banka anëtare ndoqën këtë trajnim.

Tema: Ekselencë në Menaxhimin e Konfliktëve

Data: 23-24 Prill

Partner: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)

Pjesëmarrës: 12

Përshkrimi: Një trajnim i bazuar kryesisht në përvojë dhe praktikë. 12 pjesëmarrësit nga bankat anëtare ishin aktivë duke dhënë komente gjatë diskutimeve, punëve individuale, në çifte dhe në grup, vetë-reflektimit, rasteve studimore, pyetësorëve. Dr. Siegfried Lachmair prezantoi mjete, instrumente dhe teknika të reja që ndihmojnë menaxherët të bëhen navigatorë më të mirë të konfliktëve - pothuajse si një trajnues ose ndërmjetës.

Në bashkëpunim me ICC Albania u ofruan dy seminare të hapura, përkatësisht për:

Kontratat model

Data: 17-18 prill

Pjesëmarrës: 5

Menaxhimi i riskut dhe negociimi në kontratat ndërkombëtare

Data: 19 Prill

Pjesëmarrës: 2

Përshkrimi: Këto dy seminare u krijuan për personat që punojnë në tregtinë ndërkombëtare (sektori privat), si dhe për konsulentët e brendshëm dhe të jashtëm, të cilët negociojnë, hartojnë, interpretojnë dhe ekzekutojnë kontratat ndërkombëtare shitjeje, shpërndarjeje dhe ndërmjet agjencive tregtare. Këto seminare ishin të rëndësishme për personat në sektorin ligjor, të prokurimit, shitjeve, dhe financave, si dhe për ata që, në rolin e tyre si menaxherë, kanë si detyrë të udhëzojnë dhe mbikëqyrin këto departamente dhe personat e përfshirë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.



Tema: Bazat e Blockchain-it në banka

Data: 7-8 Maj

Trajnues: David Gyori

Pjesëmarrës: 11

Përshkrimi: Trajnimi ku morën pjesë 11 persona nga bankat anëtare përfshinte: Koncepti i Blockchain-it; Projektet aktuale të blockchain-it; Siguria kundrejt Blockchain-it; dhe Çfarë do të bëjë banka në lidhje me blockchain-in?

Tema: Bankingu i hapur, API-të dhe PSD2

Data: 9-10 Maj

Trajnues: David Gyori

Pjesëmarrës: 11

Përshkrimi: Direktiva e Shërbimeve të Pagesave: Historia; rreziqet dhe përgjegjësitë që lidhen me PSD2; Roli i ri i Konkurrencës dhe Bashkëpunimit ishin disa nga temat e prezantuara nga eksperti David Gyori gjatë trajnimit dy-ditor, ku morën pjesë 11 pjesëmarrës.

Tema: Ekselencë në Shitje Thesari

Data: 14-15 Maj

Partner: BACEE

Pjesëmarrës: 10

Përshkrimi: Ky trajnim ofroi njohuri të thelluara rreth elementeve njerëzore të personave që merren me shitje thesari, me anë të prezantimeve, praktikave të komunikimit dhe lehtësimin e punës kolektive të 10 pjesëmarrësve.

Tema: Pjesa e parë e rishikimi i provimit të CIA-s

Data: 22-23 Maj

Partner: Instituti Shqiptar i Auditimit të Brendshëm (AIIA)

Pjesëmarrës: 10

Përshkrimi: Ky trajnim u krijua për të ndihmuar kandidatët që të kuptojnë temat e trajtuara në Provimin e parë të Certifikimit të CIA-s. Trajnimi u drejtua nga Stavri Pashko dhe e ndoqën 10 pjesëmarrës.

Tema: Të udhëheqësh me Inteligjencë Emocionale

Data: 23-24 Maj

Partner: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)

Pjesëmarrës: 14

Përshkrimi: Disa nga objektivat e kursit përfshijnë: Kuptimi i koncepteve të inteligjencës emocionale për zhvillimin e cilësive të fuqishme drejtuese; Kuptimi dhe zbatimi i parimeve dhe metodave për vetë-ndërgjegjësimin, përshtatjen dhe menaxhimin e emocioneve, vetëdijen sociale për të kuptuar të tjerët dhe ndërtimin dhe menaxhimin e marrëdhënieve. Kursi u ndoq nga 14 pjesëmarrës.



Tema: Shitja e shërbimeve financiare dhe menaxhimi i marrëdhënieve me klientët

Data: 28-30 Maj

Partner: House of Training – ATTF

Pjesëmarrës: 20

Përshkrimi: Kursi u dha një vështrim të qartë të teknikave të shitjes pjesëmarrësve që synojnë të shesin shërbime dhe produkte për klientët dhe të menaxhojnë në mënyrë efektive marrëdhëniet me klientët.

Tema: Vlerësimi i talenteve

Data: 12-13 Qershor

Partner: AIMS International

Pjesëmarrës: 13

Përshkrimi: Një trajnim eksperimental, me njohuri, ekspertizë, mjete të testuara, raste studimore dhe skenarë praktikë të menduar për të ndihmuar profesionistët që të vlerësojnë në mënyrë objektive dimensionet themelore, nxitësit dhe faktorët që përcaktojnë sjelljen dhe performancën e një personi në një mjedis profesional.

Tema: Kursi GARP "Bazat e riskut financiar" dhe Përgatitja e Trajnuesve

Data: 18-22 Qershor

Partnerë: IFC

Pjesëmarrës: 23

Përshkrimi: Një kurs tre-ditor certifikimi nga GARP, i ndjekur nga një provim dhe një trajnim të specializuar "Trajnoj Trajnuesin" (TOT) për të mësuar aftësitë dhe teknikat për të përgatitur kandidatët që të japin këtë kurs. Ky program ofroi një kuptim të thellë dhe cilësor të metodologjive të menaxhimit të riskut, strukturave qeverisëse për menaxhimin e riskut në banka, dhe parimet rregullatore të përcaktuara nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare. Në trajnim morën pjesë pjesëmarrës nga Shqipëria dhe Kosova.

Tema: Menaxhimi i mashtrimit

Data: 18-19 Shtator

Partnerë: PricewaterhouseCoopers (PWC) në Shqipëri

Pjesëmarrës: 15

Përshkrimi: Ndër temat kryesore të trajtuara ishin llojet kryesore të mashtrimit, treguesit kryesorë që lidhen me humbjet nga mashtrimi, kush i kryen mashtrimet dhe burimi i akteve të mashtrimit, profili i mashtruesve, pasojat e mashtrimit - humbjet financiare, pasojat ligjore dhe dëmtimi i reputacionit.



Tema: Kuadri COSO - ERM - Procesi i Vlerësimit të Riskut

Data: 24-25 Shtator

Partnerë: Instituti Shqiptar i Auditimit të Brendshëm (AIIA)

Pjesëmarrës: 19

Përshkrimi: Programi i trajnimit përfshin rolin e auditimit të brendshëm; kuadri i riskut dhe kontrollit; menaxhimi i riskut; teknikat e vlerësimit të riskut dhe angazhimi i auditimit i bazuar në risk.

Tema: Puna në grup - Krijimi dhe drejtimi i një ekipi fitues

Data: 8-11 Tetor

Partnerë: Gila Yaniv (M.A), Trajnuese dhe konsulente për zhvillimin e karrierës

Pjesëmarrës: 33

Përshkrimi: AAB mundësoi organizimin e një trajnimi 4-ditor të bankave anëtare me temë "Puna në grup - Krijimi dhe drejtimi i një ekipi fitues". Falë drejtimit të trajnueses ndërkombëtare Gila Yaniv, trajnimi ofroi tregues praktike për mënyrën e formimit të ekipeve për zgjidhjen e problemeve të prekshme në punë dhe për të përmirësuar proceset reale të punës, rishikimin e projekteve dhe ecurisë, përfshirjen e argëtimit dhe aktiviteteve të përbashkëta në agjendën e organizatës.

Tema: Menaxhimi i sigurisë kibernetike dhe të informacionit

Data: 15 - 17 Tetor

Partnerë: House of Training – ATTF

Pjesëmarrës: 26

Përshkrimi: Trajnimi përfshiu fusha të ndryshme të Sigurisë Kibernetike dhe u ndoq nga pjesëmarrës nga bankat, Banka e Shqipërisë dhe institucione të tjera financiare. Në fund të këtij kursi, për pjesëmarrësit u paraqit një përmbledhje e sigurisë kibernetike dhe një vështrim për mënyrën se si të zbuten rreziqet që lidhen me të.

Tema: Menaxheri si Trajnues

Data: 17 - 19 Tetor

Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)

Pjesëmarrës: 13

Përshkrimi: Ky trajnim ndërveprues u mbajt nën drejtimin e Larrisa Winter-it. Trajnimi u mendua për të ndihmuar menaxherët të rritin efektivitetin e tyre si udhëheqës dhe të çojnë drejt suksesit ekipin duke frymëzuar dhe zhvilluar njerëzit e tyre përmes trajnimit.



Tema: Të udhëheqësh përmes Inteligjencës Emocionale

Data: 12-13 nëntor

Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)

Pjesëmarrës: 12

Përshkrimi: Një trajnim ndërveprues dy-ditor, i cili ofroi një gamë të gjerë aftësish për të ndihmuar pjesëmarrësit të rrisin vetëdijen personale dhe sociale dhe të përmirësojnë vetë-menaxhimin dhe menaxhimin e marrëdhënieve. Trajnuesja e programit ishte Larisa Winter.

Tema: Identifikimi i krimit financiar përmes rritjes së vigjilencës së duhur kundër pastrimit të parave

Data: 12-13 nëntor

Partnerë: Instituti Shqiptar i Auditimit të Brendshëm (AIIA)

Pjesëmarrës: 17

Përshkrimi: Trajnimi u përqendrua në tema të tilla si financiare, Këmbimin Valutor dhe shërbime pagesash/dërgesa parash. Në këtë seminar u dha informacion dhe u theksuan pikat kryesore që lidhen edhe prekin të gjitha shtetet. Seminari u bazua në diskutimet e studimeve të rasteve, menaxhuar nga ekspertë me përvojë në Mbretërinë e Bashkuar dhe mbështetur nga ekspertë vendas të Njësisë së Inteligjencës Financiare.

Tema: Menaxhimi i Njerëzve për menaxherët e grupeve

Data: 4-6 Dhjetor

Partnerë: House of Training – ATTF

Pjesëmarrës: 17

Përshkrimi: Trajnimi u përqendrua në ushtrimet praktike dhe kontributin e pjesëmarrësve në sfidat e tyre aktuale të biznesit lidhur me menaxhimin e personave. Trajnimi u mbajt nga Z. Gilles de Mendez, një ekspert nga Luksemburgu.

Tema: Trajnim online për Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR) për bankat

Partnerë: House of Training – ATTF

Të shpërndara 115 licenca

AAB-ja prezantoi për herë të parë trajnimin online për GRDP “pa pagesë”, i mbështetur fuqimisht nga ana financiare nga Qeveria e Luksemburgut. ATTF ka shpërndarë 115 licenca për punonjësit e bankave tregtare. Licenca është e vlefshme për 2 muaj dhe të gjithë përdoruesve u duhen maksimumi 2 orë për të përfunduar kursin. Ata do të pajisen me një certifikatë pasi të kenë përfunduar trajnimin dhe pasi të kenë kaluar me sukses provimin.

Tema: Trajnim në internet mbi teknologjinë e informacionit

Partnerë: BIT Albania

Trajnim në internet për 100 përdorues

AAB në bashkëpunim me BIT Albania, lidhi marrëveshjen për të ofruar trajnime në internet mbi TIK për 100 përdorues të sektorit bankar. Përmbajtja përfshin nivelin bazë dhe të avancuar të Paketës Office në gjuhën shqipe dhe angleze.



BOTIME

Raporti vjetor 2018

Raporti Vjetor i AAB-së, i cili është botuar në korrik, përfshin zhvillimet dhe veprimtaritë kryesore të AAB-së përgjatë vitit 2017.




Raporti CSR 2018

Bankat për Shoqërinë

Për tre vite radhazi, AAB-ja prezanton kontributin e bankave në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Raporti konsiderohet si një standard i ri komunikimi i themeluar mbi ofrimin e informacionit për kontributin e bankave në shoqëri dhe ekonomi. Në botimin e vitit 2018, të përgatitur me mbështetjen dhe konsulencën e OKB, u soll një strukturë e përmirësuar e prezantimit të kontributit të bankave në shërbim të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe të

Përgjegjësisë Sociale të Korporatave. Për më tepër, Objektivat prezantohen në dy seksione: Mundësitë për vlera të përbashkëta, të cilat janë ato mundësi që bankat kanë pritshmërinë të përbëjnë një vlerë të shtuar si për aksionarët ashtu edhe për shoqërinë. Ato përfaqësojnë një veprim që hap rrugë më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse drejt rritjes ekonomike, prosperitetit dhe mirëqenies.

Aktivitete të tjera si donacione dhe sponsorizime, që nuk konsiderohen si OZHQ, janë të përmbledhura nën seksionin e Përgjegjësisë Sociale të Korporatave.



Revista "Bankieri"


Katër botime të revistës "Bankieri" janë përgatitur dhe botuar gjatë vitit 2018. Këto përfshijnë artikuj të shkruar nga ekspertë bankarë, akademikë, përfaqësues të biznesit, etj. Revistat mund të shkarkohen në internet dhe në profilet përkatëse në rrjetet sociale.



Video

Gjatë vitit 2018, AAB-ja vazhdoi të publikonte video informative të serisë "Banka Ime" mbi Edukimin Financiar.

- Si Të Bëhesh Klient i Bankës
- Bankingu Digjital



Fushata për rritjen e ndërgjegjësimit në përdorimin e kartave

AAB zhvilloi një fushatë edukuese kombëtare, me mbështetjen e Mastercard, për uljen e përdorimit të parave cash dhe rritjen e përdorimit të instrumenteve alternative të pagesave, duke edukuar mbajtësit e kartave në Shqipëri për përfitimet e tyre.

Kjo fushatë kishte për synim:

- Rritjen e ndërgjegjësimit mbi avantazhet e përdorimit të pagesave novatore në një mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt;
- Rritjen e besimit në përdorimin e transaksioneve "pa kontakt" për pronarët e shtëpive;
- Uljen e volumit të "ekonomisë gri" përmes zvogëlimit të transaksioneve me para cash.

Fushata përmbante spote reklamuese në TV dhe radio. Gjithashtu, fushata e mediave sociale u postua në platforma të ndryshme.



KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET e AAB-së ME PUBLIKUN

Përfaqësuesit e AAB-së morën pjesë në disa tryeza të rrumbullakëta dhe forume, duke prezantuar kështu pozicionin e AAB-së në çështjet e shtjelluara në to.

Vetë Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së është ftuar shpesh në mbajë fjalën e tij ose të marrë pjesë në aktivitete të tilla në Shqipëri dhe në Evropë, për të shpalosur këndvështrimin e tij lidhur me çështje tematike kyçe të këtij sektori.

Aktivitetet e AAB-së kanë pasur mbulim të gjerë në media përgjatë gjithë 2018 dhe Sekretari i Përgjithshëm ka dhënë mbi 20 intervista përgjatë vitit.

Media Sociale

Nën ritmin e dimensioneve të tejskajshme që kanë marrë mediat sociale, tashmë përballemi me një tjetër sfidë, pasi çdo kanal mediatik na ofron rezultate të ndryshme të dhënash. Duke përcaktuar qartë se cila rrugë do të çonte drejt suksesit, AAB tashmë mund të analizojë në thellësi se çfarë ka funksionuar, çfarë nuk ka funksionuar dhe si të përshtatë siç duhet informacionet në të ardhmen.

Objektivat e vendosura dhe të përmbushura përgjatë vitit:

- Një faqe interneti e përmirësuar dhe e përditësuar. Video të shkurtra për edukimin financiar. Video të shkurtra informuese. Fushata të sponsorizuara.
- Prania në mediat sociale: përditësimi dhe ruajtja e një pranie dinamike e AAB-së përmes faqes së saj të internetit, Facebook, LinkedIn dhe Twitter.
- Një llogari e re në Instagram.
- Zhvillim i mëtejshëm i një strategjie të medias sociale me shumë kanale.



KOMITETE TEKNIKE

Arritje dhe përmbledhje

Komitetet teknike zhvilluan mbi 40 takime gjatë vitit 2018 dhe më pas çështjet e identifikuara nga këto Komitete u ndoqën më tej nga Sekretariati i AAB-së.

Komiteti i Sigurisë së Bankës

Anëtarët e Komitetit organizuan disa takime gjatë këtij viti, ku diskutuan mbi çështjet e sigurisë dhe masat shtesë që do të marrin bankat anëtare pas nxjerrjes së akteve të reja nënligjore. U analizua funksionimi i masave të sigurisë, zbatimi dhe pasqyrimi i tyre në ndryshimet e akteve nënligjore përkatëse të kontratave të shërbimit me SPMS. U organizua një takim i përbashkët me kolegët nga Kosova, me qëllim për të kuptuar më mirë incidentet e ndodhura në vendin fqinj. Një nga shqetësimet më të mëdha ishte ajo e grabitjeve të bankave dhe sulmeve të ATM-ve në Kosovë si edhe të rasteve të ngjashme që ndodhën kohëve të fundit në Shqipëri.

Sekretariati i AAB-së, së bashku me anëtarët e tjerë të komitetit, u takuan me Zëvendës Ministrin e Brendshëm, për të trajtuar shqetësimet që lidhen me përbërjen e grupit të eskortës brenda qytetit dhe përdorimin e bojës së sigurisë. Mes çështjeve të tjera të rëndësishme të diskutuara ishte Udhëzimi Nr. 130, datë 05.03.2018 "Për shërbimet private të sigurisë fizike" dhe ndikimi që ka ky udhëzim në sektorin bankar.

Komiteti i Kartave

Komiteti organizoi dhe filloi në 4 maj veprimtarinë e vitit, me planifikimin dhe organizimin e Forumit vjetor të Kartave, duke u fokusuar kryesisht në përdorimin e kartave dhe reduktimin e parave cash. Pas Forumit, çështjet që u trajtuan nga Sekretariati dhe Komiteti i Kartave ishin si më poshtë:

- Fushata e Edukimit Financiar.
- Komunikimi me institucionet publike për të rritur pagesat me anë të kartave dhe për të zvogëluar përdorimin e parave cash.
- Përmirësimi i raporteve statistikore të publikuara nga Banka e Shqipërisë. Për këtë qëllim u krijua një grup pune nga Komiteti për të paraqitur një kërkesë me propozime konkrete në strukturën përkatëse të Bankën e Shqipërisë.

Vazhdon puna për të gjitha këto nisma.

Gjithashtu, anëtarët kontribuan gjatë vitit në rishikimin e Rregullores Nr. 11 "Për Instrumentet e Pagesave Elektronike" dhe e draftit të strategjisë për pagesa me vlerë të vogël.

Komiteti i Përputhshmërisë

Një ndër çështjet kryesore shqetësuese ishte edhe projektligji "Mbi disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit". Më 27 Dhjetor, Drejtorja e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP) organizoi një takim me Komitetin Përputhshmërisë së AAB-së, me praninë e Z. Arlind Gjokutaj, Drejtor i Përgjithshëm i DPPPP. Gjatë takimit, u zhvilluan disa diskutime dhe u shprehën mendime lidhur shqetësimet dhe propozimet e bankave për ndryshimet e propozuara në ligjin në fjalë dhe u ra dakord për të rishikuar disa nga ndryshimet e propozuara.

Komiteti i Burimeve Njerëzore

Përveç angazhimit të komitetit me Sekretariatit për hartimin e kalendarit të trajnimit dhe të çështjeve për edukimin financiar, ata gjithashtu u përfshinë në diskutime lidhur me aktet nënligjore të ndryshme të nxjerra gjatë këtij viti, siç është Vendimi nr. 68 «Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore».

Anëtarët e Komisionit vlerësuan mundësinë për të kryer një anketë mbi angazhimin dhe efikasitetin e punonjësve bankarë, përveç pjesëmarrjes vjetore në Anketën e Pagave të Sistemit Bankar në Shqipëri. Sekretariati i AAB-së vazhdoi të përpunojë të dhënat e anëtarëve për të përgatitur Raportin mbi Burimet Njerëzore KPI, në mënyrë që të kenë një standard të mirë-përcaktuar për sektorin.

Komiteti i Sigurisë së Informacionit

Gjatë vitit, agjenda e Komitetit të Sigurisë së Informacionit u përqendrua në bashkëpunimin e mirë me agjencitë shtetërore, organizimin e Forumit mbi Sigurinë Kibernetike «Menaxhimi i Riskut» dhe përshtatjen e trajnimeve teknike për komunitetin bankar, në bazë të marrëveshjes që AAB nënshkroi me Qendrën e Trajnimeve në Luksemburg.

Këto takime shërbyen gjithashtu si një forum midis anëtarëve për të diskutuar kryesisht lidhur me rreziqet dhe incidentet e ndodhura kohëve të fundit, veçanërisht për sulmet kibernetike ndaj sistemeve bankare si nga këndvështrimi i veprimeve konkrete që duhen mbështetur dhe i menaxhimit të tij përballë palëve të tjera/autoriteteve.

Dy draft rregulloret p.sh. "Për metodologjinë e organizimit dhe funksionimit të CSIRT-eve në nivel kombëtar" dhe "Për kategoritë e incidenteve kibernetike si dhe formatin dhe elementët e raportit" të sjella nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) diskutuar gjatë një procesi konsultimi në një tryezë të rrumbullakët me palët përkatëse. U morën në konsideratë shumica e komenteve të anëtarëve të bankave.

Projektligji i ri për Shërbimin e Pagesave, i paraqitur nga Banka e Shqipërisë, është një tjetër temë në të cilën u përqendrua komiteti gjatë këtij viti, veçanërisht lidhur me masat e sigurisë së informacionit të dhëna nga bankat për të mbrojtur shërbimet e tyre, të tilla si: pagesa në internet, tregti elektronike dhe transaksione të tjera (përfshirë aksesin në llogaritë bankare përmes e-banking ose portaleve të ndryshme) si kërkesë e bërë nga ALCIRT.

Komiteti i Teknologjisë së Informacionit

Më 23 Mars, Komiteti i Teknologjisë së Informacionit AAB organizoi takimin e parë. Gjatë takimit u diskutua lidhur me rregulloren prej së cilës do të qeveriset ky komitet dhe gjithashtu u zgjodh kryesia e

komitetit, p.sh Znj. Alketa Lamce, përfaqësuese e Intesa Sanpaolo Bank Albania si Kryetare, Znj. Irena Rushaj përfaqësuese e Union Bank dhe z. Altin Kona, përfaqësues i Bankës Kombëtare Tregtare, si Nënkryetar.

Më 22 tetor, Komiteti i Teknologjisë së Informacionit diskutoi kryesisht lidhur me nevojat e Komitetit për vitin 2019, si dhe nevojën për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me kërkesat e projektligjit të ri për Shërbimin e Pagesave, të paraqitur nga Banka e Shqipërisë (BSH), si dhe për rëndësinë e seminareve që do të organizohen nga BSH për këtë çështje.

Komiteti i Audituesve të Brendshëm

Gjatë vitit, komiteti organizoi si pjesë të agjendës disa takime ku anëtarët diskutuan mbi rregulloret e BSH lidhur me përcaktimin e funksioneve të auditimit të brendshëm, nevojën për sqarime dhe interpretime, ICAAP dhe bashkëpunimin me autoritetin e mbikëqyrjes, trajnimet e punonjësve të bankës, nevojën për trajnime teknike specifike, etj.

Bankat Anëtare ishin jashtëzakonisht aktive gjatë gjithë muajit maj, i cili është Muaji i Sensibilizimit të Auditimit të Brendshëm Ndërkombëtar, që synon promovimin e vlerave të auditimit të brendshëm. Anëtarët i kushtuan një rëndësi të madhe organizimit të seminarit «Kërkesat rregullatore lidhur me rolin e auditimit të brendshëm në banka», të organizuar në 16 nëntor.

Komiteti Ligjor

Gjatë vitit 2018, Komiteti Ligjor i AAB-së është përfshirë në çështjet e kuadrit ligjor mbi tarifën e procedurës përmbartimore.

Në janar, Komiteti Ligjor dhe Kryesia e Komitetit të Sigurisë së Bankave, diskutuan për masat shtesë të sigurisë që do të ndërmerren nga bankat dhe për ofrimin e shërbimeve të sinjaleve telefonike të dërguara në dhomën e kontrollit të Drejtorisë Vendore të Policisë. Shqetësimet e diskutuara u ngritën përmes një letre drejtuar Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë

Në prill, Komiteti Ligjor i AAB-së dhe Kryesia e Komitetit të Thesarit dhe Tregjeve Financiare të AAB-së diskutuan mbi projekt-marrëveshjet "Marrëveshja e Riblerjes" dhe "Marrëveshja Master për Transaksionet e Derivateve Financiare", dhe i miratoi ato në parim si marrëveshje model për bankat anëtare të AAB-së. Në varësi të secilit rast, palët në marrëveshje mund të rishikojnë afatet dhe kushtet lidhur me të.

Gjatë muajit gusht në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë u paraqitën propozimet e unifikuara nga anëtarët e Komitetit Ligjor lidhur me procedurat tatimore, për tu shqyrtuar më vonë në paketën fiskale.

Në korrik, përfaqësuesit e Sekretariatit të AAB-së dhe Kryesisë së Komitetit Ligjor të AAB-së zhvilluan një takim me ekspertë të BE-së, të cilët vlerësuan situatën e vendit dhe hartuan një raport përfundimtar të pavarur për Komisionin Evropian dhe vendin përfitues (në këtë rast për Shqipërinë) me një vlerësim të kapacitetit të vendit për të zbatuar në mënyrë efektive vendimet gjyqësore në çështjet civile, përfshirë çështjet e të drejtave tregtare dhe të pronësisë. Përfaqësuesit e AAB-së, mes problemeve të tjera të vogla, theksuan çështjen e tarifave të përmbartimit dhe nevojën për të nxjerrë një ligj specifik lidhur me ekzekutimin e procedurave që synojnë përcaktimin e procedurave të qarta, të afateve dhe të tarifave. Reforma në tarifën e përmbartimit konsiderohet e nevojshme.

Komiteti i Marrëdhënieve me Publikun

Edukimi Financiar ishte tema kryesore e takimit të organizuar në 9 shkurt. Pjesëmarrësit u informuan për aktivitetet e planifikuara për të organizuar nga AAB-ja gjatë Javës së Parave si dhe u diskutua mbi mundësitë e bankave për të mbështetur disa nga këto aktivitete. Një tjetër çështje e diskutuar gjatë takimit ishte Raporti CSR i vitit 2017 që do të përgatitet nga AAB-ja, dhe mundësia për të raportuar aktivitetet e bankave duke i harmonizuar me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Komiteti i Sistemeve të Pagesave

Takimi i 4-të i Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave dhe konferenca e organizuar nga Banka e Shqipërisë më 21 qershor 2018, me temën "Modernizimi i sistemeve të pagesave me vlerë të vogël" ishin në fokusin e Komitetit.

Anëtarët gjithashtu morën pjesë në Takimin vjetor të Grupit të Përdoruesve SWIFT («UGM»).

Komiteti i Thesarit dhe Tregut Financiar

Seminari për Zhvillimin e Tregut të Obligacioneve të Qeverisë së Shqipërisë paraqet një mundësi shumë të mirë për anëtarët e komitetit që të kontribuojnë në projektin më të ri pilot për zhvillimin e tregut të titujve qeveritarë që Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore do të iniciojnë në Shqipëri. Agjenda përfshin forcimin e tregut të obligacioneve qeveritare dhe menaxhimin e borxhit publik. Palët e ndryshme të interesit diskutuan dhe miratuan një udhërrëfyes të realizueshëm me afate dhe përgjegjësi të mirë-përcaktuara.

Komiteti i Riskut

Gjatë vitit, anëtarët e Komitetit u përqendruan në tre projekt rregullorë, të dërguara paraprakisht nga Banka e Shqipërisë për konsultim, d.m.th. "Për Raportin e Mbulimit të Likuiditetit", "Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat, të kredi-marrësve në vështirësi financiare", «Për administrimin e riskut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja».

Përveç komunikimeve të tij mbi tre projekt rregulloret, grupet e punës, të përbëra nga gjashtë banka (Alpha Bank Albania, ABI Bank, BKT, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Raiffeisen Bank dhe Tirana Bank), organizuan disa takime gjatë muajit gusht.

Më 17 gusht, Sekretariati i AAB-së organizoi një takim me përfaqësuesit e bankave dhe përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë, për të diskutuar në lidhje me qëndrimin e fundit të AAB-së ndaj Raportit të Mbulimit të Likuiditetit. Drafti përfundimtar u dërgua në Bankën e Shqipërisë.

Komiteti i Posaçëm i CFO-ve

Më 13 dhjetor, CFO-të e bankave u mbledhën për të diskutuar në lidhje me pozicionin e industrisë bankare për sa i përket ndikimit fiskal të zbatimit të SNRF 9, i cili përfshinte një punë të konsiderueshme për bankat.

TAKIME TË TJERA GJATË 2018

Takime me institucionet publike

Për pasqyrat financiare - Më 19 janar, përfaqësues të nivelit të lartë të bankave dhe Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë morën pjesë në takim për çështjen e bilancit të dyfishtë. Në vijim të këtij takimi, bankat, përmes Sekretariatit, paraqitën në Bankën e Shqipërisë propozimet e tyre alternative lidhur me ndryshimet më të fundit rregullatore.

Për reformën e derregullimit - Reforma e derregullimit u ndërmor nga Qeveria Shqiptare. Në këtë kontekst, diskutimet mbledhën së bashku Zëvendës Kryeministrin, ministrat dhe përfaqësuesit e bankave, përkatësisht:

- Më 2 shkurt u organizua një takim i përqendruar në lehtësimin e shërbimeve për qytetarët dhe sipërmarrjen. Takimi u mbajt nga Zëvendës Kryeministri, Ministri Z. Ahmetaj, Ministria Znj. Qato dhe përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës. Përfaqësuesit e qeverisë prezantuan arritjet e reja në lidhje me procedurat dhe certifikimet që lidhen me ministrinë e tyre.
- Më 2 shkurt, një takim tjetër u drejtua nga Zëvendës Kryeministrja, Ministri Z. Xhafaj, Ministria Znj. Xhaçka dhe përfaqësues nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. Për më tepër, përfaqësues nga shoqatat e biznesit morën pjesë në takim. Takimi u përqendrua në derregullimin e këtyre ministrive dhe qasjen e përqendruar të qytetarëve.
- Më 5 shkurt, me kërkesë të Zëvendëskryeminstres Znj. Mesi dhe Ministres Znj. Qato, u organizua një drekë pune me përfaqësues të biznesit në lidhje me propozimet për derregullime të mëtejshme. Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së mori pjesë në këtë drekë pune dhe prezantoi nevojën e industrisë bankare për të pasur akses në portalin qeveritar e-Albania.

Mbledhje me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të PPP&FT

- Më 9 shkurt u mbajt një mbledhje diskutimi lidhur me procedurat e mbartjes së vlerave monetare të transportuara nga bankat tregtare nga Aeroporti Ndërkombëtar i Rinasit, në bazë të Ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 15, datë 16.02.2009 i Ministrisë të Financave "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit në sistemin doganor". Palët ranë dakord për një qasje bashkëpunuese dhe të gjitha hapat e mëtejshëm do të merren në bazë të një marrëveshje të përbashkët.

Zbatimi i SNRF 9

- Më 18 Prill, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u takua me Drejtoreshën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Znj. Vasilika Vjero për të diskutuar ndikimin e SNRF 9 në industrinë bankare. Në këtë mbledhje, diskutimet u përqendruan në nevojën për një dokument me shkrim për DPT-në për të kuptuar më mirë skemën e ndikimit të kontabilitetit të SNRF 9, nevojën për të trajnuar inspektorët e taksave dhe për shqyrtim më të mirë të mundësive për të ndryshuar kuadrin aktual ligjor, nëse është e nevojshme për shkak të kërkesës nga sektori bankar.
- Më 21 Shtator u mbajt një mbledhje në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Për më tepër, një ekip nga KPMG mori pjesë në këtë mbledhje, i cili u përqendrua në ndikimet fiskale nga miratimi i SNRF 9.

Zhvillimet e tregut të titujve

Më 17 Prill, Banka Botërore, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe bankat zhvilluan një mbledhje për të diskutuar projekt-marrëveshjet për zhvillimin e projektit të tregut të titujve qeveritarë.

Digjitalizimi i shërbimeve publike

Digjitalizimi i shërbimeve publike ishte objekt i mbledhjes të organizuar në 17 maj, ku morën pjesë këshilltari i Zëvendës Kryeministrit, Banka e Shqipërisë, AKSHI dhe Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së.

Çështja e tarifave përmbartimore

Më 13 qershor, Ministri i Financave, Ministri i Drejtësisë dhe Guvernatori organizuan një mbledhje për të diskutuar projekt udhëzimet e paraqitura nga Ministri i Financave për përmbartuesit privatë për tarifën fikse dhe të suksesit. AAB u përfaqësua nga Kryetari i saj, anëtarët e Bordit Drejtues dhe Sekretari i Përgjithshëm. Gjatë kësaj mbledhjeje, ishin të ftuar edhe përfaqësues nga FMN-ja, Banka Botërore dhe Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Privatë (NCHPB). Gjatë këtij takimi, Kryetari i AAB-së deklaroi qëndrimin e AAB-së rreth nevojës për të ulur tarifën e përcaktuara në vitin 2017, dhe përputhjen e tyre me ndryshimet e propozuara për tarifën e përmbartimit. Në fund, Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë këshilluan AAB-në dhe NCHPB-në që të krijojnë një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të gjejnë një qëndrim të përbashkët për tarifën, dhe të paraqesin rezultatet e tyre tek ministrat përkatës brenda datës 21 qershor.

Më 20 qershor u mbajt një mbledhje teknike ndërmjet përfaqësuesve të AAB-së dhe Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Privatë (NCHPB). AAB-ja e mbështeti projekt-udhëzimin e paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe nuk paraqiti propozime për ndryshime. AAB-ja e shprehu qartë qëndrimin e saj pro tarifave fikse të parashikuara në udhëzimin e projektit të paraqitur nga Ministria e Financave dhe se ishte e hapur për të negociuar për tarifën e suksesit. Pas takimit, propozimet e NCHPB-së u diskutuan nga fillimisht nga Bordi Drejtues i AAB-së dhe më pas iu shpërndanë të gjithë anëtarëve të AAB-së.

Mbledhje me përfaqësuesit e Zyrës së Regjistrimit të

Pasurive të Paluajtshme

Më 8 Nëntor u organizua një mbledhje në ambientet e AAB-së, ku morën pjesë Z. Valdrin Pjetri, Kryeregjistruesi i Republikës së Shqipërisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në mbledhje morën pjesë përfaqësues nga bankat anëtare dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ku u diskutua për bashkëpunimin e mëtejshëm për ofrimin e shërbimeve të pagesave në kohë reale për qytetarët.

Mbledhje me përfaqësuesin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Më 13 nëntor, Komiteti i Thesarit dhe Tregut Financiar i AAB-së mirëpriti në AAB përfaqësuesit e AMF-së, të cilët prezantuan projektligjin e ri për Tregun e Kapitalit. Qëllimi ishte të hartohet një projektligj që mbulon rregullimin e tregjeve të kapitalit dhe jo vetëm të titujve. Prandaj do të kryhet harmonizimi i ligjit të ri me ligjin e Tregjeve në kuadrin e Direktivës së Instrumenteve Financiarë (MiFID) dhe Tregjet që lidhen me të në kuadrin të Rregullores së Instrumenteve Financiare (MiFIR), së bashku me direktivat e tjera përkatëse siç është Rregullorja mbi Prospektin, Direktiva e Transparencës dhe Rregullorja e shmangies së Abuzimit të Tregut.

TAKIME ME INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE

Për pagesat elektronike

Në kontekstin e nismave dhe projekteve në tregun e pagesave dhe promovimin e përdorimit të pagesave elektronike, u organizua një mbledhje me përfaqësuesin e bankave dhe MADFOOATCOM, një shoqëri me fokus në pagesat elektronike. Mbledhja u organizua në 23 Janar, si pasojë e interesit të shfaqur nga shoqëria për tregun shqiptar dhe në të morën pjesë gjithashtu përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë dhe përfaqësuesit e shoqërive të shërbimeve publike.

Projekti i Byrosë Kombëtare të Kredive

- Më 19 shkurt u organizua një mbledhje me përfaqësuesit e CRIF. Mbledhja u organizua në kontekstin e nismës për fillimin e një projekti të krijimit të Byrosë Kombëtare të Kredive në Shqipëri.
- Më 6 qershor, Kryetari i AAB-së së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së u takuan me përfaqësuesit e kompanisë CRIF.
- Më 19 qershor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u takua me përfaqësuesit e BERZH-it. Gjatë këtij takimi, palët diskutuan ecurinë e Projektit të krijimit të Byrosë Kombëtare të Kredive në Shqipëri.

Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ)

Gjatë takimit të mbajtur më 22 shkurt, përfaqësuesit e OKB-së u informuan se AAB-ja është angazhuar në mënyrë aktive me bankat që ato të shndërrojnë aktivitetet e tyre për përgjegjësinë sociale të korporatave në përpjekje konkrete për OZHQ. Gjatë 2 viteve të fundit, Raporti Vjetor i përgjegjësisë sociale të korporatave i AAB-së është hartuar në përputhje me OZHQ-të dhe bankat po raportojnë aktivitetet e tyre vjetore për përgjegjësinë sociale të korporatave për secilën prej OZHQ-ve. Megjithëse konsiderohet si një iniciativë mbresëlënëse, bankat aktualisht po rishikojnë përafrimin e OZHQ-ve me qëndrimin e tyre social si një sfidë kryesore.

Për Programin e Reformës Ekonomike në Shqipëri 2018-2020

Pas përfundimit të dokumentit për Programin e Reformës Ekonomike (ERP) 2018-2020 nga autoritetet shqiptare, një mision nga selia e KE-së i përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare (DG ECFIN), Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Punësimit (DG EMPL) vizituan Tiranën gjatë datave 1-2 Mars 2018, për t'u takuar me institucionet përkatëse shtetërore përgjegjëse për koordinimin në lidhje me procesin e PRE-së dhe zbatimin e tij, si dhe me organizatat ndërkombëtare dhe palë të tjera të interesuara. Në këtë kontekst, më 2 Mars, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së morri pjesë në mbledhjen për hedhjen e ideve me përfaqësuesit e selisë së KE-së.

Për mjetet e zgjidhjes së NPL-së - Misioni i IFC-së që punon në sektorin financiar vizitoi Tiranën në datat 22-23 maj 2018. Më 22 maj, u organizua një mbledhje për të diskutuar mbi mjetet e zgjidhjes së NPL-së që bankat përdorin për rimëkëmbjen e NPL-së në Shqipëri, duke përfshirë edhe mundësitë e tregut për shitjen e NPL-ve dhe mbështetjen që IFC-ja mund të ofrojë në këtë fushë.

Zhvillimet e tregut parësor në Shqipëri

AAB mundësoi mbledhjet e organizuara nga palët dhe bankat e saj anëtare në kuadër të Projektit pilot për obligacionin qeveritar 5-vjeçar referencë. Palët ranë dakord për kushtet dhe afatet e Marrëveshjes së Zhvilluesve të Tregut dhe Marrëveshjes së Riblerjes së Titujve, në mënyrë që të plotësojnë dhe forcojnë efikasitetin e tregut të Obligacioneve Referencë. Mbledhjet do të ndiqen nga seanca trajnimi nga përfaqësuesit e Reuters në lidhje me platformën e tregimit që do të përdoret nga zhvilluesit e tregut.

Më 26 korrik, palët u mbledhën për të diskutuar mbi rezultatet e ankandit dhe planin e emetimit të Obligacioneve Referencë, përvojën e zhvillimit të tregut në tregun sekondar dhe një përmbledhje të hapave të nevojshëm për të përmirësuar më tej kushtet për zhvillimin e tregut.

Më 22 Nëntor, bankat që përfaqësojnë "Komitetin e Zhvilluesve të Tregut" në kuadër të projektit pilot për obligacionin qeveritar 5-vjeçar të standardeve, mbajtën një takim me përfaqësuesit e MF-së, BB-së dhe BSH-së, ku diskutimet u përqendruan kryesisht në performancën e ankandit në formatin e projektit pilot (Reagimet), në financimin e brendshëm të tregut/kalendarin e rishikuar pas emetimit të obligacioneve në euro. Diskutime pati mbi raportimin e problemeve të hasura dhe reagimet e zhvilluesve të tregut në lidhje me vazhdimësinë e projektit pas Dhjetorit 2018.

Për Strategjinë Kombëtare për Pagesat me vlerë të vogël


Më 12 Shtator, në kuadër të një vizite të një Misioni të Bankës Botërore për të zbatuar Strategjinë Kombëtare të Pagesave me vlerë të vogël 2018-2023, më 10-13 Shtator, u mbajt një mbledhje e veçantë me AAB-në dhe përfaqësues nga disa banka (BKT, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Tirana Bank, Raiffeisen Bank, Credins Bank). Tema e diskutimit ishte të analizoheshin pagesat e institucioneve shtetërore dhe kanalizimi i tyre përmes instrumenteve të pagesave elektronike.

Mbledhje informuese mbi zhvillimet e tregut financiar

AAB-ja u ofron vazhdimisht njohuri dhe informacion partnerëve të saj, duke komunikuar rregullisht dhe duke u siguruar që anëtarët dhe bashkëpunëtorët janë të informuar për të gjitha çështjet më të fundit dhe më të rëndësishme. Në mënyrë që përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare të njihen me zhvillimet e tregut financiar dhe të marrin informacion të hollësishëm mbi sektorin bankar në Shqipëri, gjatë vitit, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së organizoi një seri mbledhjesh informuese me përfaqësues nga disa institucioneve ndërkombëtare dhe shoqëri të shërbimeve financiare, udhëheqës në sektorin financiar. Temat e diskutuara gjatë këtyre mbledhjeve: përmbledhje e përgjithshme e sektorit bankar dhe politikave të industrisë për NVM-të; segmenti i korporatave në Shqipëri; rekomandime të hollësishme për mënyrën e përmirësimit të aksesit dhe përdorimitin e shërbimeve financiare, projektin e Byrosë Kombëtare të Kredive, tarifave të përmbaruesve, çështjet e huave dhe konsolidimit e mbikëqyrjes bankare, zhvillimet rregullatore, arsimin financiar dhe sfidat dhe problemet e tjera me të cilat sektori bankar po përballet kohët e fundit.

Disa nga partnerët e AAB-së që morën pjesë në mbledhjet informuese:

Grupi i Bankës Botërore; Ekipi i Bashkimit Evropian; Shoqata Shqiptare e Mikrofinancës; PricewaterhouseCoopers (PwC), Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC); McKinsey; Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE); Agjencia Franceze e Zhvillimit; Banka Delubac; VISA; Transtrack International, etj.

A white outline of a document with a checkmark on the right side, set against a solid orange background. The document outline is a rectangle with a checkmark shape on the right edge. The text is centered within the document outline.

FIGURES
ON THE
MEMBER
BANKS

Banka	Struktura e Aksionarëve	Vendi i origjinës	Aktivet gjithsej (ALLO00)	Kreditë neto (ALLO00)	Investime në letra me vlerë të Qeverisë (ALLO00)
 BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE	Calik Finansal Hizmetler A.S. 100%	Turqi	424,915,261	131,068,756	160,292,096
 Raiffeisen BANK	Raiffeisen SEE Region Holding GmbH 100%	Austri	222,851,339	87,092,290	60,109,547
 CREDINS bank	Renis Tershana 21.181% Aleksander Pilo 15.297% B.F.S.E. Holding BV 16.485% Drejtesit e Përgjithshëm të Bankës 6.727% Të tjerë 38.309%	Shqipëri Shqipëri Hollandë Shqipëri	193,755,728	94,239,937	43,796,570
 INTESA SANPAOLO BANK Albania	Intesa Sanpaolo S.p.A. 100%	Itali	171,343,934	43,928,731	57,762,514
 SOCIETE GENERALE ALBANIA	Société Generale Minority Shareholder 88.89% 11.11%	Francë Shqipëri	82,207,133	47,470,157	18,996,325
 abi AMERICAN BANK OF INVESTMENTS	Tranzit shpk 100%	Shqipëri	77,815,291	24,721,153	29,342,340
 ALPHA BANK	Alpha Bank A.E. 100%	Greqi	77,107,771	35,459,774	9,940,006
 TIRANA BANK	Piraeus Bank S.A. 98.83% Ioannis Tzivelis 1.17%	Greqi	72,964,854	20,845,099	23,857,367
 UNIONBANK	Unioni Financiar Tirane Sh.p.k. 86.34% Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim 10.12% Individë 3.54%	Shqipëri Britani e Madhe Shqipëri	415,679	179,492	144,519
 ProCredit Bank	ProCredit Holding AG & Co. KGaA 100%	Gjermani	31,965,256	22,327,562	1,632,594
 Fibank First Investment Bank	Fibank AD 100%	Bullgari	24,633	11,713	7,540
 INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK rëndësi kanë vlerat	ICB Financial Group Holding 100%	Zvicër	10,217,996	4,887,059	3,199,341
 UBA Banka e Bashkuar e Shqipërisë United Bank of Albania	Islamic Development Bank 86.7% Ithmaar Bank 4.63% Dallah Albaraka Holding Co. 2.32% Business Focus SDN BHD 1.47% Saudi Brother Commercial Co. 0.58% Individë 4.31%	Arabia Saudite Bahrain Bahrain Malajzi Arabia Saudite Arabia Saudite	8,564,860	4,726,570	n/a
 CBA CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT E SHQIPËRIË	Kharafi Group 100%	Kuvajt	1,530,919	–	–
Total			1,375,680,653	516,958,293	409,080,759

Të dhënat e audituara sipas IFRS, në 31.12.2018 (1 EUR = 12342 ALL) (në mijë ALL)

Kapitali i vet (ALLO00)	Depozita (ALLO00)	Fitimi neto (ALLO00)	Nr. i degëve	Nr. i punonjësve	Nr. ATM	Nr. i kartave të lëshuara	Karta Debiti	Karta Krediti	Nr. POS	E-banking	Mobile Banking	E-commerce
46,872,870	337,449,629	6,300,256	93	1,292	146	429,928	364,702	65,226	6,829	Yes	Yes	Yes
27,002,686	187,797,088	3,377,523	76	1,273	177	243,586	216,597	26,989	1,060	Yes	Yes	Yes
15,534,087	167,282,686	392,615	58	870	69	161,677	156,432	5,245	992	Yes	Yes	Yes
20,274,284	145,483,303	436,707	34	640	51	106,655	106,267	388	587	Yes	Yes	Yes
7,175,570	67,353,709	(558,531)	35	423	70	54,124	53,132	992	n/a	Yes	Yes	No
9,065,429	65,670,499	569,031	34	469	43	28,379.00	27,457	922	–	Yes	No	No
8,661,932	61,787,196	(977,956)	33	422	46	68,677	59,615	9,062	1,124	Yes	Yes	No
12,651,773	57,164,880	(1,631,469)	37	430	66	61,117	57,639	3,478	124	Yes	No	No
37,294	334,619	4,354	30	384	39	34,328	28,818	5,510	30	Yes	Yes	No
3,133,342	20,671,213	(783,528)	5	165	16	14,063	13,974	89	–	Yes	Yes	No
3,408	20,807	401,032	12	183	29	30,099	26,323	3,776	n/a	Yes	No	No
1,257,379	7,702,185	(65,792)	6	99	7	1,374	1,374	n/a	n/a	Yes	No	No
1,762,717	6,564,597	30,791	6	76	n/a	823	823	n/a	n/a	No	No	No
997,564	18,902	(68,465)	1	22	0	0	0	0	0	n/a	n/a	n/a
154,430,335	1,125,471,439	742,656,7	460	6,748	759	1,234,007	1,113,153	121,677	10,746	12	9	4

* Të dhënat për Credit Bank of Albania janë sipas raportimit më 30 shtator 2018.

**PASQYRAT FINANCIARE TË
SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018**

Përmbajtja:

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

PASQYRAT E POZICIONIT FINANCIAR

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

PASQYRA E FLUKSIT MONETAR

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Stafin Drejtues të Shoqatës Shqiptare të Bankave

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB ose Subjekti), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit dhe pasqyrën e fluksit monetar për vitin e mbyllur, dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit ekonomik më 31 dhjetor 2018, ecurinë e tij financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për opinionin

Auditimi ynë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin e raportit tonë lidhur me Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne veprojmë në mënyrë të pavarur nga Subjekti, në përputhje me Kodin e Etikës së Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi IESBA), së bashku me kërkesat etike që lidhen me auditimin tonë të pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe gjithashtu kemi përmbushur të gjitha përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin IESBA. Ne besojmë se të dhënat e marra për auditimin janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat Financiare të AAB për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 nuk janë audituar.

Përgjegjësitë e stafit drejtues për pasqyrat financiare

Stafi drejtues është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK, dhe për një kontroll të tillë të brendshëm siç përcaktohet nga stafi drejtues, duhet të mundësohet përgatitje e pasqyrave financiare pa asnjë deklaratë të gabuar materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, stafi drejtues është përgjegjës për vlerësimin e aftësive të Subjektit për vazhdimësinë e aktivitetit, duke deklaruar, sipas rastit, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit dhe duke përdorur bazën e vazhdimësisë së aktivitetit, përveç rastit kur stafi drejtues synon të likuidojë Subjektin ose të ndërpresë operacionet, ose kur nuk ka ndonjë alternative realiste për të vepruar kështu.

Stafi drejtues është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Subjektit.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë asnjë deklaratë të gabuar materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të vendosim në dispozicion raportin e audituesit ku përfshihet opinionin ynë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk përbën garanci që auditi i kryer në përputhje me SNA-të do të zbulojë gjithmonë një deklaratë të gabuar materiale kur ajo në të vërtetë ekziston.

Deklaratat e gabuara mund të lindin për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe konsiderohen materiale nëse, veçmas ose në tërësi, ato pritet të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme vendimet ekonomike të përdoruesve, të cilat mund të jenë marrë në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë një gjykim profesional dhe ruajmë një skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e deklaratave të gabuara materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që lidhen me këto rreziqe, dhe marrim prova të auditimit, të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një deklarate të gabuar materiale që rrjedh nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keq-ushtime ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Përpiqemi të kuptojmë kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në mënyrë që të hartojmë procedura auditimi të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionin për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Subjektit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël, bazën e arsyeshme të parashikimeve kontabël dhe deklaratat përkatëse të dhëna nga stafi drejtues.
- Dalim në përfundime lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vazhdimësisë së aktivitetit nga ana e stafit drejtues, bazuar në provat e marra gjatë auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme në aftësinë e Subjektit për vazhdimësinë e aktivitetit. Nëse dalim në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit për deklaratat përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto deklarata janë të papërshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit të audituesit tonë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e mëvonshme mund të bëjnë që Subjekti të ndërpresë vazhdimësinë e aktivitetit.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë edhe deklaratat, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në mënyrë të tillë që të arrihet një prezantim i drejtë.

Ne komunikojmë me stafin drejtues të Shoqatës Shqiptare të Bankave në lidhje me, ndër të tjera, objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të konsiderueshme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël i Autorizuar
Albania Branch

Ernst & Young Certified Auditors

26 June 2019
Tirana, Albania

Mario Vangjel
Certified Auditor



SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<u>AKTIVET</u>			
<i>Aktive afatshkurtra</i>			
Arka dhe Banka	4	8,325,877	18,441,678
Kontribute te arketueshme	5	2,750,371	1,144,626
Shpenzime të parapaguara	6	280,160	365,503
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		11,356,408	19,951,808
<i>Aktivet Afatgjata</i>			
Aktivet e qëndrueshme, neto	7	1,136,034	931,706
Totali i Aktiveve Afatgjata		1,136,034	931,706
TOTALI I AKTIVEVE		12,492,442	20,883,515
<u>DETYRIMET</u>			
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>			
Llogari të pagueshme		2,927,346	663,968
Fatura të pa mbërritura		17,600	-
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra	8	2,944,946	663,968
Aktivet Neto	9	9,547,496	20,219,546
TOTALI I DETYRIMEVE		12,492,442	20,883,515

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

	Shënime	Per vitin e mbyllur me 31dhjetor2018	Per vitin e mbyllur me 31dhjetor2017
<u>TË ARDHURAT</u>	10		
Kuotat e anëtarësisë		20,164,000	39,311,000
Të ardhura për trajnime		5,886,609	5,119,088
Sponsorizime		3,757,355	542,149
Totali i të Ardhurave		29,807,964	44,972,237
<u>SHPENZIMET</u>			
Amortizimi	7	(289,557)	(237,595)
Shpenzimi organizimi	11	(14,966,667)	(15,526,243)
Shpenzime promovimi dhe publikime	12	(3,897,246)	(4,787,866)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrimi	13	(21,176,926)	(20,242,189)
Humbjet nga kursi i këmbimit		(149,616)	(36,550)
Totali i Shpenzimeve		(40,480,013)	(40,830,442)
Teprica e të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		10,672,049	4,141,795
Aktivet Neto në fillim të vitit		20,219,546	16,077,751
Aktivet Neto në fund të vitit		9,547,497	20,219,546


Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

PASQYRA E FLUKSIT MONETAR

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytëzimit</i>			
Teprica/Deficiti i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		10,672,049	4,141,795
Rregullime për:			
Amortizim	8	289,557	237,595
Pagesa për shpenzimet e parapaguara	7	85,343	421,407
Llogari të arkëtueshme		(1,605,745)	(217,804)
Pagesa për llogaritë e pagueshme	9	(2,280,978)	(641,588)
Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit		9,621,916	3,941,405
<i>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</i>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	8	(493,886)	(254,820)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		(493,886)	(254,820)
RRITJA NETO E MJETEVE MONETARE		10,115,801	3,686,585
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	4	18,441,678	14,755,093
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	4	8,325,877	18,441,678

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) janë përpiluar në datë 20.03.2019 dhe nënshkruar nga:



Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave

Pasqyra e Fluksit monetar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)

1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar më 15 Prill 1999 me seli në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, SkyTower, Kati 9, Ap.3, Tiranë, Shqipëri.

AAB është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përpiqet të promovojë standardet më të fundit Bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 16 anëtarë, mbi baza vullnetare: Alpha Bank Shqipëri, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Banka SocieteGeneral Albania, Banka Credins, Banka e Kreditit të Shqipërisë, FIBank Albania, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka IntesaSanPaolo Shqipëri, Banka NBG Shqipëri, Banka ProCredit, Raiffesien Bank Shqipëri, Tirana Bank, Banka Union, Banka e Bashkuar e Shqipërisë dhe Veneto Banka.

2. Baza e Përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me SKK për OJF-të dhe ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. SKK për OJF-të ka hyrë në zbatim nga data 1 janar 2016.

Pasqyrat Financiare paraqiten në Lek (ALL), e cila është dhe monedha funksionale e Shoqatës.

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

- Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë si të ardhurat që lidhen me to.

Të ardhurat kryesore të Shoqatës vijnë nga tarifatat e anëtarësimit, të cilat janë subjekt i miratimit të Asamblesë së Anëtarëve.

Të ardhurat regjistrohen kur realizohen dhe shpenzimet regjistrohen kur ndodhin.

- Transaksionet në monedhë të huaj

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un (ALL). Të gjitha kontributet dhe pjesa dërrmuese e shpenzimeve janë në lekë (ALL). Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin në datën e kryerjes së transaksionit. Të gjitha balancat në monedhë të huaj në fund të vitit janë konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të vitit si vijon:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Euro	123.42	132.95

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël (vazhdim)

- Aktivitet Afatgjatë Materiale (AAM)

Vlerësimi fillestar i elementeve që plotësojnë kriteret e njohjes si AAM në bilanc është bërë me koston e blerjes plus kostot e tjera të drejtpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhje dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të Shoqatës. Vlerësimi vijues është bërë sipas modelit të koston dhe AAM-të paraqiten në bilanc në vlerën neto (minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e mundshme nga zhvlerësimi, nëse ka). Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes.

Normat e amortizimit dhe metoda sipas grupeve:

	Norma e Amortizimit	Metoda e përdorur
Pajisje Informatike	25%	Vlera e mbetur
Mobilje/Orendi	20%	Vlera e mbetur
AAM të tjera	20%	Vlera e mbetur

- Tatimet dhe Taksat

AAB është një shoqëri jo fitimprurëse dhe, si e tillë, është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore, si dhe taksave vendore.

4. Arka dhe Banka

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogari rrjedhëse në lekë	6,992,962	17,120,898
Llogari rrjedhëse në euro	1,302,003	1,215,120
Para në arkë	30,912	105,659
Gjithsej	8,325,877	18,441,678

5. Kontribute të arkëtueshme

Kontributet e arkëtueshmepërbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrime nga antarët	2,750,371	1,144,626
Gjithsej	2,750,371	1,144,626

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)***6. Shpenzime të parapaguara**

Shpenzime të parapaguara përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Garanci qera	280,160	280,160
Siguracion shëndeti	-	85,343
Gjithsej	280,160	365,503

7. Aktivet e Qëndrueshme

Aktivet e Qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

	Mobilje / Orendi	Pajisje Kompjuterike	Gjithsej
Kosto			
Në 31 dhjetor 2017	2,013,701	1,477,587	3,491,288
Shtesat gjatë vitit 2018	11,990	481,896	493,886
Pakësimi gjatë vitit 2018	-	-	-
Në 31 dhjetor 2018	2,025,691	1,959,483	3,985,174
Amortizimi i Akumuluar			
Në 31 dhjetor 2017	1,582,954	976,628	2,559,582
Amortizimi gjatë vitit 2018	62,422	227,135	289,557
Pakësimi gjatë vitit 2018	-	-	-
Në 31 dhjetor 2018	1,645,376	1,203,763	2,849,139
Vlera Neto			
Në 31 dhjetor 2017	430,747	500,959	931,707
Në 31 dhjetor 2018	380,315	755,720	1,136,035

8. Llogari të Pagueshme

.Llogaritë e pagueshme përbëhen nga sa vijon:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Furnitorë	2,336,914	166,990
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	204,704	185,969
Tatimi mbi te ardhurat personale	380,590	273,448
Tatim në Burim	5,138	16,400
Personeli	-	21,160
Fatura të pa mbërritura	17,600	-
Gjithsej	2,944,946	663,967

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)***9. Aktivet Neto**

Aktivi neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të OJF-së në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Ndryshimi në aktivet neto paraqitur në pasqyrën e aktiviteteve artikullohet në aktivet neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar.

Aktivitet neto të paraqitura si të pakufizuara përdoren në periudhat vijuese vetëm për objektivat e përcaktuara në statutin e shoqatës.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Në fillim të periudhës	20,219,546	16,077,751
Rritje/(Ulje) në aktivet neto	(10,672,049)	4,141,795
Vlera e bartur në vitin e ardhshëm	9,547,497	20,219,546

10. Të Ardhurat

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Tarifa anëtarësimi nga bankat anëtare	20,164,000	39,311,000
Trajnim perbankat anëtare	5,886,609	5,119,088
Sponsorizime nga bankat	3,757,355	542,149
Gjithsej	29,807,964	44,972,237

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)***11. Shpenzime Organizimi**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Evente dhe Tryeza pune	5,285,413	8,087,915
Anëtarësime	706,040	1,179,840
Udhëtime	789,031	1,432,571
Trajnime bankat anëtare	8,186,183	4,825,917
Gjithsej	14,966,667	15,526,243

12. Shpenzime promovimi dhe publikime

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Publikime	3,722,704	4,394,132
Materiale informative dhe publicitet	174,542	393,733
Gjithsej	3,897,246	4,787,866

13. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrimi

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Paga personeli	11,709,443	10,924,505
Qira	3,070,900	3,223,240
Konsulence Financiare	2,528,790	1,685,665
Kontribute për sigurime	1,315,385	1,138,539
Shpenzime komunikimi	1,091,136	1,425,942
Kancelari dhe të tjera të konsumueshme	572,317	529,103
Shpenzime të tjera	302,313	514,527
Sigurim shëndeti	275,093	313,371
Shpenzime utilitare	148,714	139,678
Shërbime përkthimi	75,089	250,940
Komisione bankare	34,766	40,396
Noterizime	22,760	25,000
Taksa lokale	15,000	15,100
Abonime	13,500	13,500
Penalitete	1,720	2,683
Gjithsej	21,176,926	20,242,189

